

*“Të mbrosh
të miturit”*

MANUAL

PËR AVOKATIN MBROJTËS
TË TË MITURIT

Përgatitur nga:
Av. Holta KOTHERJA
Av. Arben RISTANI

Botimi i këtij manuali u mundësua nga UNICEF-i dhe u përgatit për botim nga Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara



Tiranë, 2007

Redaktoi:
Arlinda Budo

Designer: *Studio "m&b"*
Shtypur: *Shtypshkronja STEVLA*

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE	7
-------------	---

I. AVOKATINË PROÇESIN PENAL

A. PËRPARA SE TË FILLOJË HETIMI

1.1.1	Konsiderata të përgjithshme	11
1.1.2	Informacion mbi marrëdhënien avokat- klient i mitur	12
1.1.3	Konsiderata etike/ Konflikti i interesit	14
1.1.4	Takimi i parë me të miturin	15
1.1.5	Vazhdimësia e kontakteve me të pandehurin e mitur	19
1.1.6	Marrëdhënia me klientin e mitur para se të fillojë procedimi	20
1.1.7	Këshillimi për vetdorëzim	21

1.1.8	Roli i avokatit kur i mituri ndodhet në ambientet e Komisarariatit të Policisë	22
1.1.9	Përgatitja e klientit të mitur dhe e prindërve të tij ..	24
1.1.10	Roli i avokatit nëse çështja ndërpritet nga prokuroria	24

B. NË FAZËN E HETIMIT

1.2.1	Roli dhe të drejtat e avokatit në procesin e hetimit	26
1.2.2	Hetimi i pavarur nga vetë avokati	27

C. MBROJTJA NË GJYKATË

1.3.1	Alternativat e mbrojtjes	28
	Kërkimi i pafajësisë	28
	Mbrojtja pohuese	29
	Ngritja e dyshimit të arsyeshëm	29
1.3.2	Gjykimi	30
	Ç' duhet të keni parasysh në mbrojtjen tuaj të parë ..	31
	Deklaratat e hapjes dhe parashtrimet hyrëse	31
	Parashtrimi hyrës i prokurorit	32
	Parashtrimi hyrës i mbrojtjes	32
1.3.3	Provat e marra jo konform ligjit	33
	Provat shkencore dhe ligjore	34
1.3.4	Mungesa e provave	35
1.3.5	Dëshmitarët e mbrojtjes dhe prezantimi i provave..	36
	Dëshmitarët e mbrojtjes	36
	Pyetja e klientit të mitur në seancën gjyqësore	37
	Prezantimi i provave	39
	Marrja në pyetje i dëshmitarëve të mbrojtjes nga prokurori - Ekzaminimi i tërthortë	41
1.3.6	Diskutimi përfundimtar dhe argumentet mbyllëse ..	41
1.3.7	Çështje të tjera për tu marrë në konsideratë	42

Kundërshtimet	42
Kundërshtimet potenciale – Lista e kundërshtimeve sipas situatës	43
1.3.8 Rastet e mos paraqitjes para gjykatës	45

II. PËRMBLEDHJE DHE SHPJEGIM I KUADRIT LIGJOR TË APLIKUESHËM GJATË MBROJTJES SË TË MITURIT

2.1 Konventa për të Drejtat e Fëmijës.....	49
2.2 Respektimi i normave procedurale	52
2.3 Arrestimi në flagrancë	52
2.4 Masat e sigurisë	53
2.5 Hetimi	54
2.6 Gjykimi.....	62
2.7 Përjashtimi nga dënimi dhe masat edukuese	64
2.8 Alternativat e dënimit me burgim	66
2.9 Dënimi me burgim për të miturit	69
2.10 Ankimimi i vendimit	70
2.11 Ekzekutimi i vendimit dhe vuajtja e dënimit me burgim	71

HYRJE

Manuali i Avokatit Mbrojtës së të Miturit synon tu vijë në ndihmë avokatëve të cilët përfaqësojnë të miturit në një proces penal. Trajtimet e këtij manuali kontribuojnë në kryerjen e një mbrojtjeje më të mirë në procesin e përfaqësimit të të miturit duke zbatuar dhe respektuar të gjithë rregullat, standartet dhe të drejtat që parashikon legjislacioni shqiptar dhe legjislacioni ndërkombëtar në këtë fushë; si p.sh. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe Rregullat dhe Standartet Minimale të OKB-së për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit), dhe Parimet e Përgjithshme mbi Rolin e Avokatit për të Miturit¹.

Nisur nga fakti që të miturit, të cilët mbajnë përgjegjësi penale sipas moshës së parashikuar në Kodin Penal, janë adoleshentë, ata përjetojnë një sërë ndryshimesh në aspektin psikologjik dhe fiziologjik për shkak të procesit të rritjes dhe maturimit të cilat edhe vetë ligji është munduar t'i adresojë duke i konsideruar subjekte të mbrojtjes së posaçme në Kushtetutën e R.SH. Për shkak të

¹ Keto parime janë vendosur në Kongresin e 8-të të Kombeve të Bashkuara mbi parandalimin e krimit dhe trajtimin e autorëve të krimit.

karakteristikave që ka kjo moshë avokatët mbrojtës duhet të jenë të pajisur me njohuri të posaçme në lidhje me:

- ndikimet e ndryshimeve të sipërpërmendura në sjelljen e të miturve;
- mekanizmat dhe instrumentet që ka parashikuar ligji në mënyrë të posaçme për të miturit;
- vendosjen e një komunikimi të përshtashëm për këtë grupmoshë.

Këto njohuri do t'u siguronin avokatëve që mbrojnë të miturit instrumentet e duhura për sa i përket mënyrës së aplikimit të ligjit, kryerjes së një mbrojtje sa më efëcente duke parë me një fokus të vecantë vendosjen e marrëdhënies avokat – klient i mitur, e cila gjithashtu meriton të jetë e ndërtuar dhe e formatuar duke marrë parasysh veçoritë e të miturit.

I gjithë informacioni që gjen pasqyrim në këtë manual është strukturuar në mënyrë më të detajuar në:

1. Marredhenien avokat – klient i mitur;
2. Evidentimin e fazave të procesit penal, veprimet që duhen ndermarr nga avokati bazuar në dispozitat ligjore perkatëse si dhe çfare duhet të ketë parasysh avokati gjatë tyre;
3. Prezantimin e kuadrit ligjor vendas dhe ndërkombëtar bazuar edhe në përvojat e avokatëve për të mitur të projektit të Klinikës Ligjore për të Miturit e Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Manuali është mbështetur në manuale të ngjashme² për mbrojtësit

² Juvenile Defender Delinquency Notebook/ National Juvenile Defender Center/ Advocacy and Training Guide- Calvin, E., Marcus, S., Oleyer, G., & Scali, M. (2006). Washington DC, American Bar Association

ligjore për të miturit dhe synon të mbushi një boshllëk në literaturën shqiptare për sa i përket përpunimit të metodologjisë dhe procesit të kryerjes së një mbrojtjeje ligjore të kualifikuar dhe sa më efçente për klientët e mitur, duke prezantuar në këtë kuadër elemente, rregulla, informacion teorik dhe praktik dhe një përmbledhje të legjislacionit të aplikueshëm për të miturit.

Av. HOLTA KOTHERJA
Drejtoe Ekzekutive
QShPLI

I. AVOKATI NË PROÇESIN PENAL NDAJ TË MITURIT

A. PËRPARA SE TË FILLOJË HETIMI

1.1.1 Konsiderata të përgjithshme

Legjislacionet më të përparuara botërore që mbikqyrin sistemin e drejtësisë për të mitur si dhe të gjitha konventat dhe rregullat ndërkombëtare në këtë fushë, si psh. Konventa e OKB-se për të Drejtat e Fëmijëve e ratifikuar nga parlamenti shqiptar në vitin 1992 apo rregullat e Pekinit dhe të Rhyadit, synojnë mirëqënien, mirërritjen, vazhdimin e edukimit e të miturve duke konsideruar se ky proces nuk ka përfunduar ende. Këto rregulla ndërkombëtare synojnë të zbusin ashpërsinë e sistemeve tradicionale, të cilat priren drejt shpagimit dhe ndëshkimit të fajtorit, gjë që shprehet qartë në mbizotërimin e dënimeve me burgim ose të masave të sigurisë me arrest në burg. Standartet ndërkombëtare synojnë të aplikojnë kryesisht masa edukative dhe pedagogjike ndaj të miturve në vend të privimit të lirisë.

Sistemi i drejtësisë për të miturit, megjithëse ka shumë ngjashmëri me sistemin penal për të rriturit, ngjashmëri që shfaqen si në aspektin material ashtu dhe në atë procedural, në të ekzistojnë dhe meritojnë të evidentohen edhe ndryshimet, pra rregullat ligjore specifike për të miturit dhe të paraqiten të detajuara siç është rasti i materialit në këtë manual.

Së pari ndryshimi qëndron në faktin se sistemi i drejtësisë për të mitur ka si qëllim kryesor rehabilitimin e të miturit dhe vazhdimin e

edukimit të tij pasi konsiderohet se proçesi i formimit dhe edukimit të të miturit nuk ka mbaruar ende deri në moshën 18 vjeç, ndërsa sistemi i drejtësisë për të rriturit ndjek qartë kryesisht qëllimin ndëshkues.

Së dyti, prindërit dhe ata që kujdesen për të miturit kanë një rol të konsiderueshëm në çështjet penale me të pandehur të mitur sepse të miturit nuk kanë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi si të rriturit. Prindërit dhe ata që kujdesen për të miturit kanë një rol të madh në të dhënat që avokati do të marrë për çështjen dhe në mardhëniet që avokati do të ndërtojë me të miturit si dhe kanë ndikim në drejtimin që do të marrë çështja.

Së treti, të miturit i sigurohet ndihmë psikologjike gjatë proçedimit penal, bazuar në nenin 35 të Kodit të Proçedurës Penale, ndihmë e cila duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, por edhe në preçedentë të krijuar kohët e fundit tek ne i është siguruar nëpërmjet psikologut specialist. Ky psikolog profesionist ndihmon jo vetëm të pandehurin e mitur për të përballuar situatën e veçantë dhe shumë delikate në të cilën ndodhet, por edhe avokatin për të kuptuar më mirë gjendjen e klientit të tij, për të analizuar më mirë situatën dhe për të ndërtuar më mirë mbrojtjen e të miturit.

1.1.2 Informacion mbi marrëdhënien avokat-klient i mitur

Marrëdhënia e avokatit me klientin e mitur është kryesore në një përfaqësim efektiv dhe për këtë duhen bërë të gjitha përpjekjet, duke filluar nga takimi i parë, për të siguruar që marrëdhënia të jetë e mirëinformuar.

Përgjithësisht avokati nuk duhet të presë që klienti t'i besojë menjëherë. Është më e mundshme që raporti me klientin të ndërtohet dhe të fillojë të forcohet pasi avokati të ketë treguar qartë angazhimin e tij në çështjen e klientit dhe respektin për interesat e tij.

Në këtë aspekt është e rëndësishme që avokati të ketë parasysh që:

- Historia personale, ambjenti social dhe zona në kuptimin gjeografik ku është rritur klienti i mitur si dhe shkolla që ka ndjekur ndikojnë në mënyrë se si ai mendon, si flet dhe si ndërton marrëdhënien me avokatin.
- Çdo klient është unik, por ka shumë mundësi që të ketë karakteristika të përbashkëta me të rinjtë që kanë pasur probleme me drejtësinë dhe që avokati ose kolegë të tjerë i kanë përfaqësuar më parë.
- Avokati duhet të ketë marrë njohuri specifike dhe duhet të ketë fituar përvojë për mënyrën e komunikimit me klientin e mitur.
- Ai duhet të mësojë më tepër për zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve. (Psikologjia dhe shkencat sociale ofrojnë një gamë të gjerë librash të cilat trajtojnë me hollësi këtë çështje).

Në ndryshim nga përfaqësimi dhe mbrojtja e një klienti të rritur, kur punoni me një klient të mitur është shumë e rëndësishme marrëdhënia që duhet të krijohet midis jush dhe prindërve të të miturit.

Duhet të jeni të qartë se ju vërtet punoni për të miturin, por ju duhet të kultivoni në të njëjtën kohë edhe një marrëdhënie me prindërit e tij. Idealisht prindërit duhet të jenë aleatët tuaj.

Në varësi të marrëdhënies prind-fëmi, të cilën ju duhet ta eksploroni, jeni ju ai që do të zgjidhni mënyrën se si do ta përfshini prindin në zgjidhjen e çështjes.

Përveç faktit se një marrëdhënie e mirë është e shëndetshme, ajo do t'ju ndihmojë që duke e bërë shumë të qartë përpara gjykatës, të mund të shmangni dënimin me heqje lirie në rastet kur çështja shkon drejt fajësisë. Kjo ndodh pasi kur gjyqtari shikon se ka të bëjë me një familje

që funksionon normalisht është më e lehtë të bindet se i pandehuri është rastësisht në rrugën e krimit dhe se masat e sigurisë ose dënimet alternative të burgimit mund t'ja arrijnë qëllimit të drejtësisë.

1.1.3 Konsiderata etike / Konflikti i interesit

Avokati në mbrojtjen e një të mituri, mban parasysh zbatimin e ligjit krahas interesit më të mirë për klientin. Këtu duhet theksuar se ajo që klienti mendon se është më e mira për të mund të mos koordinojë me mendimin e avokatit për çka është më e mira për interesin e klientit. Kur shfaqet kjo kontradiktë, rekomandohet që roli i avokatit të konsistojë në sqarimin e pasojave ligjore të çdo zgjedhjeje dhe në ndihmimin e klientit të mitur të marri vetë një vendim. *Për të marrë një shembull: në rast se klienti dëshiron të shprehet vetë rreth akuzës dhe rrethanave të ngjarjes dhe avokati ka mendimi se është në të mirën e klientit që ai të mos shprehet, duhet që avokati t'i sqarojë klientit pasojat ligjore që do të vijnë nga mbajtja e një pozicioni të caktuar, pse ajo që mendon avokati është më e mira për interesat e klientit dhe në fund të lërë klientin të vendosë nëse do të shprehet vetë apo jo.*

➤ *Konflikti i interesave*

Kodi i Etikës së Avokatit, miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve me datë 12.11. 2005, parashikon në nenin 20-24 një sërë situatash kur avokati konsiderohet si në konflikt interesi me klientin, nga të cilat mund të përmendim përfaqësimin e dy ose më shumë klientëve në një çështje në rast se ekziston konflikt interesi. Gjithashtu në kod parashikohet se avokati duhet të tërhiqet nga përfaqësimi apo mbrojtja në rast se ekziston rreziku i shkeljes së besimit të klientit të mëparshëm, ose në rast se njohja që zotëron avokati nga çështja e klientit të mëparshëm do të përbënte epërsi të padrejtë për klientin e ri. Është e rëndësishme të theksohet se për klientin e mitur, parashikimet e mësipërme mund të shtrihen edhe kur një nga situatat e mësipërme

ekziston për një marrëdhënie me prindërit e të miturit, pavarësisht se diçka e tillë nuk është parashikuar në Kodin e Etikës së Avokatit.

Bazuar në sa më lart është shkelje e kodit të etikës së avokatit nëse ai përfaqëson një klient kur ka konflikt interesash në çështje. P.sh. avokati nuk duhet të përfaqësojë një klient nëse interesat e klientit janë të kundërta me ato të avokatit apo me kliente të tjera të avokatit.

Në këto raste rekomandohet të mos diskutohen me klientin faktet e çështjes përpara se të jetë eliminuar konflikti i interesave, i cili është jo vetëm shkelje e kodit etik të avokatit por shfaqja e tij dhe keqmenaxhimi i zgjidhjes mund të çënojë rëndë raportin e besimit midis avokatit dhe klientit të mitur.

1.1.4 Takimi i parë me të miturin

Biseda e parë e avokatit me klientin e mitur është shumë e rëndësishme, pasi hedh themelet e një marrëdhënie të fortë avokat-klient i mitur, e më tej një përfaqësim të suksesshëm.

E mira është që ky takim të bëhet në një ambient që krijon kushte konfidencialiteti. Rekomandohet zyra e avokatit dhe vënie në dispozicion e kohës së duhur të bisedës, në mënyrë që avokati të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për çështjen. Ndërkohë që bisedohet me klientin e mitur duhet të kihet kujdes të mbahet qetësi në qëndrim dhe në zë, në mënyrë që dhe i mituri të kuptojë që avokati ka gjithë kohën e nevojshme për të biseduar. E njëjta gjë duhet të mbahet parasysh edhe kur takimi bëhet në ambientet ku i mituri mbahet i ndaluar apo i arrestuar.

➤ *Prezantoni veten*

- Takimi duhet të fillojë me prezantimin e avokatit me veten, punën që bën, përvojën si dhe me rolin që ka në çështje;
- Duhet të theksoni se ju jeni aty për të miturin, jo për prindin, prokurorin apo gjykatësin;

- Duhet të siguroni të miturin që jeni në anën e tij dhe se biseda juaj do të mbetet e fshehtë;
- Shpjegojini se sa e rëndësishme është marrëdhënia avokat-klient;
- Mund t'i jepni numrin e telefonit dhe t'i siguroni që mund t'ju marrë në çdo kohë.

Shembull i një bisede të parë

Përsëritet, emri im është... Unë jam avokati yt. *[pak heshtje]*
 Ke patur ndonjëherë një avokat? Jo? Epo, më lejo të të them se ç' do të thotë të kesh avokat. Së pari, marrëdhënia jonë do të jetë krejt ndryshe nga çdo marrëdhënie tjetër që ke patur me të rriturit. Unë punoj për ty, jo për mamin, babin tënd, as për gjykatën – vetëm për ty. Detyra ime është të të ndihmoj të kuptosh se çfarë ndodh në një proces si ky që ka nisur ndaj teje. Unë do të punoj që të kujdesem për këtë çështje. Nuk do të të them unë çfarë të bësh, por do të diskutojme të gjejmë një zgjidhje së bashku. Ke ndonjë pyetje? *[heshtje, dëgjoni]* Tjetra që doja të të thoja është se çdo gjë që do të themi këtu do të mbetet sekret, e fshehtë. E di se çfarë dua të them me këtë? A ma shpjegon dot me fjalët e tua se çfarë kuptove? *[heshtje, dëgjoni]* po, tamam. Dhe ka një ligj që thotë që mua nuk më detyron dot asnjëri që ta tregoj atë që më ke thënë. Dhe prandaj unë dhe ti mund të flasim për çdo gjë, dhe kjo do të mbetet këtu, në këtë dhomë. Nuk do t'ia përsëris askujt ato që ke thënë, nëse ti nuk ma lejon. Si të duket kjo? *[heshtje, dëgjoni]*
(në këtë pikë i jepni numrin e telefonit dhe sigurojeni që mund t'ju marrë në çdo kohë)

Sigurisht që çdo avokat ka stilin e tij individual, por e rëndësishme është që t'i tregoni besnikëri të miturit. Shumë shpesh të miturit në konflikt me ligjin kanë vlerësim të ulët për veten dhe vijnë nga familje të varfra. Ata mund të kenë vështirësi të besojnë të tjerët, për shkak të përvojave të kaluara. Prandaj është e rëndësishme të përpiqeni që të ndërtoni një marrëdhënie të mirë besimi. Kjo do t'ju ndihmojë të ndërtoni një strategji mbrojtjeje të fortë dhe të suksesshme.

➤ Njihuni me të miturin

Pyeteni klientin në çfarë klase është, ku jeton, çfarë i pëlqen dhe çfarë jo, gjërat me të cilat merret, gjendjen familjare. Kjo e bën të ndihet komod dhe të fillojë komunikimin me ju. Nga ana tjetër të dhënat mund t'ju ndihmojnë të kuptoni të miturin dhe nivelin e zhvillimit të tij, të cilat mund të jenë më pas të vlefshme për procesin e mbrojtjes, si për shembull: i mituri mund të përmendë një mësues, mik, familjar.

➤ Shpjegojini çfarë po ndodh

I mituri që nuk është përsëritës, në më të shumtën e rasteve është i traumatizuar nga përballja me ligjin dhe është e rëndësishme që atij t'i shpjegohet me kujdes dhe me hollësi se çfarë po ndodh, p.sh.:

- Çfarë parashikon ligji për veprën për të cilën i mituri akuzohet;
- Si zhvillohet hetimi i një çështjeje;
- Sa kohë mund të duhet deri në përfundim.

Është mirë gjithashtu nëse i mituri garantohet se nuk do të jetë vetëm në këtë përballje, por avokati dhe prindërit apo të afërmit e tij do t'i gjenden pranë për ta kaluar së bashku këtë problem.

➤ Këshilla për të marrë në pyetje të miturit

- *Krijoni një strategji komunikimi*

Është e rëndësishme që të krijoni një strategji se si do të pyesni dhe do të komunikoni me të miturit. Përpara se të hartoni pyetjet tuaja merrni mirë parasysh moshën, gjininë, historinë, aftësitë apo paaftësitë, gjendjen emocionale e të miturit. Adoleshentët, aq më tepër nëse kanë ndonjë problem apo çrregullim emocional, mund të ngatërrohen me terma të vështirë apo me gjuhë të sofistikuar. Ata mund të mos i kuptojnë pyetjet e gjata dhe mund të kenë vështirësi në mënyrën se si i përshkruajnë ngjarjet. Kurdo që të flisni me të miturin artikulojeni pyetjen me shumë kujdes, nëse doni të merrni të dhëna të sakta. Disa këshilla konkrete janë:

- *Bëni kujdes që pyetjet të jenë të thjeshta dhe të qarta.*

Nëse i mituri përdor fjalë të thjeshta dhe fjali të shkurtra, të njëjtën gjë duhet të bëni edhe ju. Pyetjet e gjata mund t'i zbërtheni në disa të shkurtra dhe një pyetje nuk duhet të përmbajë më tepër se një ide. Shmangni zhargonin ligjor.

- *Kujdes nga keqkuptimet.*

Nëse ju duket se përgjigjet e të miturit nuk janë konsistente, apo ajo që thotë nuk ka shumë kuptim, shqyrtoni mënyrën se si e keni bërë pyetjen, mënyrën si është artikuluar, toni me të cilën është bërë, apo shikoni nëse fëmija ka patur një tjetër interpretim gjuhësor të saj. Është shumë e rëndësishme që ju dhe klienti juaj të keni të njëjtin kuptim për fjalë të caktuara. Prandaj nëse vini re ndonjë inkonsistencë apo hutim tek i mituri pyeteni drejtpërdrejt se ç'kuptoi ai me ato fjalë.

- *Sigurohuni që e kuptoni të miturin*

Mos ngurroni ta pyesni që t'ju shpjegojë zhargonin e tij nëse ju nuk e kuptoni.

Mos e pyesni të miturin drejtpërdrejt për koncepte abstrakte si p.sh. çfarë mendon ai për të vërtetën dhe gënjeshtren.

- *Përsëritja e pyetjeve dhe qartësimi i informacionit*

Përsëritja e pyetjeve apo fjalëve të caktuara në bisedën me të miturit shpesh është e nevojshme. Është më mirë që të përsëriten emrat e njerëzve dhe të vendeve se sa të përdoren përemra.

➤ *Kujdes*

Kujdes të mos i thoni të miturit fjali si: “përgjigju pyetjes time me po ose me jo”. Kjo jo vetëm që mbyll komunikimin, por ngatërron të miturin i cili mendon se përgjigjet duke thënë “nuk e mbaj mend”.

Gjatë verifikimeve të bëra nga policia, gjatë procedurave të ndalimit, të marrjes së masës së sigurisë apo gjatë seancave të marrjes në pyetje të të pandehurit të mitur nga prokurori, ndodh shpesh që të

miturit t' i bëhet e njëjta pyetje disa herë apo t' i kërkohet të tregojë një pjesë të ngjarjes disa herë. Është e nevojshme që avokati ti shpjegojë të miturit arsyet se përse ndodh kjo situatë. Normalisht arsyeja mund të jetë fakti se është menduar që i pandehuri ka gënjyer në përgjigjen e parë, ka dhënë përgjigje kontradiktore apo nuk ka thënë atë që kanë pritur të tjerët që ai të thotë.

Kur pyesni të miturin rreth çështjes mundohuni të merrni sa më shumë detaje që të jetë e mundur. Për këtë arsye, lëreni t'ju tregojë të gjithë historinë pa e ndërprerë dhe më pas pyesni për detajet që ju interesojnë.

1.1.5 Vazhdimësia e kontakteve me të pandehurin e mitur

Është shumë e rëndësishme që të mbahen kontakte të vazhdueshme me të pandehurin e mitur. Këshillohet që frekuenca e takimeve të jetë jo më e vogël se një herë në dy javë kur i pandehuri është i lirë dhe jo më pak se një herë në javë kur i pandehuri është i paraburgosur.

Do të jepte shumë rezultat në marrëdhënien tuaj me klientin e mitur nëse ju do ta takonit ndonjëherë atë në shtëpinë e tij.

Është e kuptueshme që çdo marrëdhënie avokat-klient i mitur ka specifikat e veta, por disa gjëra kryesore që duhet të jenë të njëjta në çdo marrëdhënie janë:

- Tregojini klientit të mitur se ju jeni shumë i interesuar për çfarë i ka ndodhur dhe për atë që ai mendon;
- Mbajeni klientin e mitur në çdo kohë të informuar për ecurinë e çështjes;
- Tregojini gjithmonë atë që po bën për çështjen;
- Përgjigjuni pyetjeve të tij hapur, thjesht dhe qartë;
- Jini korrekt dhe i përgjegjshëm për kërkesat e klientit;
- Mbajini gjithmonë premtimet.

➤ *Kujdes*

Duhet bërë shumë kujdes që të mos premtohen gjëra për të cilat nuk jeni absolutisht i sigurt. Besimi dhe fakti që avokati punon për dhe sipas interesave të klientit duhet të bëjë që të punoni duke u konsultuar shpesh me klientin, qoftë ai edhe i mitur.

1.1.6 Marrëdhënia me klientin e mitur përpara se të fillojë procedimi

Kodi i Proçedurës Penale ka parashikuar në nenin 35 se të pandehurit të mitur i jepet ndihmë juridike dhe psikologjike në çdo gjendje dhe shkallë të proçedimit, megjithëse vetë dispozita shfaqet pak problematike në lidhje me momentin kur të miturit i lind e drejta për ndihmë juridike, pasi neni 35 i KPP e lidh atë me të qënëit i pandehur, që sipas nenit 34 të KPP është personi të cilit i atribuohet vepra penale me njoftimin e akuzës, dhe me fillimin e proçedimit. Megjithatë prania e mbrojtësit përcaktohet në mënyrë të qartë edhe në nenin 256 të KPP, ku përcaktohet se prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore merr në pyetje të arrestuarit dhe të ndaluarit në prani të mbrojtësit dhe në nenin 295 - 296 të KPP, ku përcaktohet afati maksimal i shoqërimit prej 12 orësh të personit të marrë nën hetim dhe verifikimi apo marrja e të dhënave nga policia gjyqësore prej tij në praninë e avokatit.

Duke përdorur instrumentat ligjore të mësipërm është shumë e rëndësishme për klientin tuaj të mitur që ju si avokati i tij të përfshiheni sa më shpejt të jetë e mundur në çështje për të mbrojtur interesat e klientit dhe për mbarëvajtjen e proçedimit. Megjithatë, praktika ka treguar se jo gjithmonë avokati arrin të lidhet me çështjen që në fazat e saj më të hershme. Në vijim të kësaj problematike, Avokati i Popullit i ka kërkuar organeve të policisë të marrin masa për një zbatim korrekt të rregullave të mësipërme proçeduriale dhe në vijim të kësaj Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i ka drejtuar Drejtorive të Policisë në Qarqe një shkresë Nr. 5025/1, Datë. 31.7.2006 me objekt marrjen e masave për garantimin dhe zbatimin e të drejtave të shtetasve për tu mbrojtur me avokat.

Në vazhdim mund të themi se:

Dy janë mënyrat më tipike për tu lidhur me çështjen që në momentet e saj të para:

- a) Klienti ju telefonon në momentin që ai kërkohet nga policia, por ende nuk është kapur;
- b) Klienti ju telefonon nga ambjentet e policisë menjëherë sapo shoqërohet ose ndalohet.

Në momentin kur policia po kërkon klientin tuaj:

1. Sigurohuni që klienti është i sigurt në momentin që flet me ju dhe nuk është i kërcënuar nga dikush që mund t'i bëjë keq;
2. Sigurohuni që në momentin që flet me ju klienti ka fshehtësinë e duhur, nëse jo mundohuni ta ndërtoni bisedën në mënyrë të tillë që gjërat të jenë të mbrojtura;
3. Mësoni nga klienti përse ai beson se po kërkohet nga policia dhe çfarë di ai për ato që kanë ndodhur;
4. Mësoni prej tij nëse është e mundur që policia ta kapi përpara se ju të keni mundësi ta takoni;
5. Merrini leje klientit tuaj që të kontaktoni me punonjësit e policisë për të marrë më shumë informacion rreth çështjes;
6. Kujdesuni për të mësuar nëse klienti i di të drejtat e tij në një rast të tillë. Kujtojini klientit që ai ka të drejtë të heshtë dhe të kërkojë avokatin në çdo kohë;
7. Ndihmoni klientin që ai të konsiderojë mundësinë e vetdorëzimit;

1.1.7 Këshillimi për vetdorëzim

Si njeri i ligjit, avokati nuk mund ta këshillojë klientin e tij që t'i fshihet drejtësisë.

Pasi të krijoni bindjen se ekziston një shkak i ligjshëm për të cilin klienti po kërkohet, atëherë duhet ta ndihmoni që ai të konsiderojë mundësinë e vetdorëzimit.

Në këtë rast duhet t'i shpjegoni klientit pasojat që ka fshehja ndaj drejtësisë dhe në të kundërt rrethanat lehtësuese që ai përfiton në rast se vetdorëzohet, pra paraqitet në organet kompetente (përkatëse) pas kryerjes së veprës penale, parashikuar nga neni 48 i Kodit Penal "Rrethanat lehtësuese".

Vetë avokati do ta ketë më të lehtë për të argumentuar përpara gjykatës, në rastet e vetdorëzimit, pendimin e klientit dhe kërkesën për masë sigurie apo dënime të buta. Në nenin 33, pika 2 e Kushtetutës së R.Sh. sanksionohet gjithashtu se nga e drejta për tu dëgjuar përpara se të gjykohet nuk mund të përfitojë personi që i shmanget drejtësisë.

Nga ana tjetër, në rastin e vetëdorëzimit klienti mund të shmangë shfaqje publike të padëshiruara për të dhe familjen e tij. Për më tepër kur klienti shoqërohet nga avokati gjatë dorëzimit shton mundësinë e zbatimit korrekt të të drejtave të tij.

1.1.8 Roli i avokatit kur klienti i mitur ndodhet në ambjentet e komisaritit policisë

Në bazë të instrumentave ligjore të parashikuara në nenin 35, 50, 53 dhe 294-295 të KPP¹⁾, mbrojtësit i garantohet bisedimi me të pandehurin e paraburgosur. Në mënyrë më të detajuar ky ligj i jep të drejtën personit të arrestuar në flagrancë apo të ndaluar që të flasë me mbrojtësin menjëherë pas arrestimit apo ndalimit. Ju si avokat duhet të gjeni menjëherë mundësinë që t'i transmetoni këto mesazhe oficerit të policisë gjyqësore që është përgjegjës për klientin tuaj.

Një shembull bisede:

"Oficer, ndërkohë që unë flas me klientin tim, është detyra ime si avokat t'ju them se ai nuk do t'ju thotë asnjë fjalë në mungesën time. Në rast se unë do të kem mundësinë të flas menjëherë me klientin tim, unë do të mundohem ta bind atë që të bashkëpunojë me ju për zgjidhjen ligjore të çështjes."

1) Kodi i Procedurës Penale

Në rast se nuk ju krijohet mundësia për t' u takuar menjëherë me klientin duhet të bëni të gjitha përpjekjet që te beni te mundur ate nepermjet ankimit perkates tek prokurorit.

Në rast se do të takoheni me klientin *sigurohuni për fshehtësinë e bisedimit*. Kur kjo fshehtësi nuk ekziston, shmangni bisedat me objekt ceshtjen dhe përqëndrohuni tek shpjegimi i të drejtave ligjore që ka klienti juaj.

Këmbëngulni që ta bindni klientin të mos bisedojë me askënd tjetër pa praninë tuaj.

Këshilloni klientin që të mos kryejë biseda thelbësore me askënd, as me familjarët e tij qoftë drejtpërdrejt apo në telefon.

➤ *Sigurohuni që klienti juaj nuk është keqtrajtuar*

Çdo person duke përfshirë këtu edhe të miturin nuk mund t' i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, parashikuar në nenin 25 të Kushtetutës së R.Sh. Kjo e drejtë u garantohet në mënyrë të posaçme personave të cilëve u është hequr liria, në nenin 28, pika 5 e Kushtetutës.

Paprekshmëria fizike shtrihet edhe në faktin që klienti të mos lejojë askënd që të ekzaminojë trupin e tij apo t' i marrin kampione gjaku, flokësh etj. Në raste të tilla ju duhet të këshilloni klientin, që me mirësjellje të refuzojë dhe të kërkojë praninë e menjëhershme të avokatit.

➤ *Njoftimi i Familjarëve të të Miturit*

Pavarësisht se organet e policisë gjyqësore apo të prokurorisë e kanë për detyrë të njoftojnë menjëherë në çdo rast familjarët e të miturit bazuar në nenin 255, pika 4 të KPP dhe jo vetëm kaq por edhe marrjen në pyetje e të miturit ta bëjnë në prezencën e prindërve në bazë të nenit 35 të KPP, avokati gjithashtu duhet të kujdeset menjëherë për të ditur nëse janë lajmëruar prinderit e klientit të mitur nga organi proçedues dhe t' i njohë ata me informacionet e nevojshme personalisht.

1.1.9 Përgatitja e klientit dhe e prindërve të tij\sjaj

Informoni klientin tuaj dhe prindërit e tij\sjaj që:

- Oficeri i policisë, pavarësisht premtimit për konfidencialitet, mund t'i tregojë të gjithë informacionin e marrë gjykatësit apo prokurorit të çështjes;
- Ai (i mituri) nuk duhet të diskutojë incidentin për të cilin akuzohet me oficerin e policisë gjyqësore. (Duhet të keni parasysh se ju si avokat mund të "akuzoheni" nga oficerët e policisë gjyqësore apo prokurori se ishit ju që e instruktuat të miturin të mos i përgjigjet pyetjeve rreth çështjes, megjithatë ju keni kryer detyrën tuaj dhe keni mbrojtur vetëm interesin e klientit tuaj të mitur brenda kuadrit ligjor);
- Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që i mituri të japë përshtypjen që e ka marrë seriozisht të gjithë procesin në të cilin merr pjesë, pavarësisht ndjenjave të fajësisë apo pafajësisë;
- Oficerët e policisë gjyqësore apo prokurori duhet të sigurojnë sa më shumë informacion mbi sjelljen e mirë të klientit dhe aktivitetet në të cilat ai është i përfshirë. Kjo përfshin ndjekjen e shkollës, sjelljen e mirë në shtëpi, kalimin e kohës me miq të cilët kanë një influencë pozitive mbi të akuzuarin etj.

Kujdes:

Mos harroni t'i kujtoni klientit dhe familjarëve të tij se nuk është mirë të ekzagjerojnë, sepse oficeri i policisë gjyqësore mund të përpiqet të verifikojë të dhënat e marra në mënyrë të pavarur. Është e rëndësishme gjithashtu që prindërit e të miturit të vishen në mënyrë të përshtatshme dhe të respektojnë rregullat e mirësjelljes.

1.1.10 Roli i avokatit nëse çështja pushohet nga prokuroria

Është e rëndësishme që ju si avokat të ekzaminoni me kujdes nëse ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal në bazë të nenit 290 të KPP apo nëse ekzistojnë kushtet për pushimin e çështjes nga organi i prokurorisë, parashikuar në nenin 328 të KPP.

Për këtë, ju duhet të jeni të gatshëm dhe të aftë të:

- Mblidhni informacion mbi klientin tuaj në mënyrë që ta prezantoni sjelljen e tij sa më pozitivisht, si për shëmbull:
 - Rezultatet në shkollë;
 - Eksperienca të përkohshme pune;
 - Pjesëmarrja në aktivitete fetare, artistike apo sportive;
 - Sjellja në shtëpi apo komunitet;
- Përdorni dokumentat të cilat dëshmojnë arritjet e klientit tuaj:
 - Diploma shkolle;
 - Çertifikata aftësie;
 - Çertifikata arritjeje.
- Kërkoni bashkëpunimin e personave që kanë lidhje me klientin tuaj të cilëve mund tu kërkoni të shkruajnë ndonjë informacion mbi marrëdhënien e tyre me klientin, performancën pozitive të klientit në fushat që kanë lidhje me të.

Qëllimi i kësaj është që t'i tregojë oficerit të policisë gjyqësore apo prokurorit se klienti nuk ka nevojë për trajtim special. Ai nuk ka pasur apo ka probleme e shqetësime të cilat mund të komplikojnë jetën e klientit në formë të tillë që ta përfshijë atë në situata konfliktuale me ligjin, për të cilat kërkohet investimi apo ndërhyrja e gjykatës.
- Kontaktoni në telefon ose takoni oficerin e policisë gjyqësore të caktuar për çështjen tuaj, përpara se ta takoni atë me klientin tuaj. Përdore telefonatën apo takimin për të marrë informacion mbi pritshmëritë e oficerit mbi rastin dhe për negociatat që mund të bëhen mbi rezultatet finale. Këtë takim mund ta përdorni edhe për të zbuluar se çfarë di oficeri i policisë mbi rastin e klientit tuaj të mitur.
- Nëse ju mund të siguroni një zgjidhje të tillë për klientin tuaj, e cila nuk përfshin gjykatën, ju duhet të bëni një takim me të miturin dhe prindërit e tij.

- Shpjegojini të miturit dhe familjarëve të tij çdo moment problematik të cilin ju e identifikuat si të tillë gjatë bashkëbisedimeve të mëparshme dhe ndërjegjësoi ata në lidhje me pasojat në rast se oficeri i policisë i rikthehet çështjes përpara se ajo të mbyllet tërësisht kryesisht në rast se persona të tjerë janë të përfshirë në një proces.
- Sigurohuni që klienti juaj apo familjarët e tij t'ju kontaktojnë nëse shfaqet ndonjë problem. (P.sh. nëse klienti juaj i mitur është përfshirë rastësisht në një zënkë, dhe dëshmitari i rastit e shqetëson vazhdimisht klientin tuaj. Në këtë rast mundohuni t'ia bëni të ditur këtë shqetësim si informacion organeve të policisë në rast se klienti i mitur së bashku me prindërit e tij nuk dëshirojnë ta depozitojnë atë si kallëzim personal).

B. NË FAZËN E HETIMIT

1.2.1 Roli dhe të drejtat e avokatit në procesin e hetimit të kryer nga prokurori

Hetimi është një term i gjerë, i cili përdoret për të treguar në përgjithësi procesin e mbledhjes së informacionit dhe provave përkatëse nga organ i akuzës. Megjithëse në dukje ky proces duket të jetë ekskluziv për prokurorinë si organi i akuzës, i mituri dhe avokati mbrojtës si përfaqësues i tij, kanë një sërë të drejtash që burojnë nga ligji themelor i shtetit, Kushtetuta e R.Sh. neni 35, pika 3 ku sanksionohet se kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

E drejta e avokatit për t'u njohur me aktet e veprimeve hetimore parashikohet gjithashtu në nenin 50, pika 1 e KPP, ku parashikohet se mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njuh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit si dhe në nenin 327, pika 2 e

KPP. Nga mënyra se si është formuluar neni 327, pika 2, është për t'u theksuar se kjo e drejtë për avokatin vjen në formën e një detyrimi për organin e akuzës, pasi ky i fundit duhet të sigurohet që mbrojtësi është njohur me aktet e veprimeve hetimore.

Refuzimi nga ana e prokurorisë për të nxjerrë provat që disponon kur pala mbrojtëse e kërkon një gjë të tillë, do të përbënte një dhunim dhe shkelje të rëndë të së drejtës për një proces të drejtë ligjor parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar.

Si avokat ju keni të drejtë:

- Të keni të drejtë hyrjeje në raportin e policisë si edhe në formulimin dhe mbështetjen në prova të akuzës së bërë kundër klientit tuaj;
- Të njiheni me listën e dëshmitarëve të mbledhur nga prokurori;
- Të njiheni me përmbajtjen e dëshmive të dhëna nga dëshmitarët e akuzës;
- Të njiheni me rezultatet e testimeve, apo provave të tjera të cilat janë të rëndësishme primare apo të natyrës fizike;

1.2.2 Hetimi i pavarur nga vetë avokati

Është detyra juaj të merreni me investigimin e të gjitha provave, të cilat janë gjetur kundër klientit tuaj. Kjo detyrë ju ngarkohet pavarësisht nga pranimet dhe pohimet e bëra nga klienti i mitur. Metoda më e mirë e mbledhjes së informacionit mbi klientin tuaj është hetimi që ju bëni, pavarësisht intervistës së parë të dhënë nga ai apo zbulimeve të bëra nga prokurori. Forma e hetimit do të zgjidhet në varësi të teorisë që ju ndiqni gjatë punës tuaj me rastet. E rëndësishme është të analizoni çdo element të mbrojtjes që do të përdorni si dhe të jepni prova për çdo gjë që ju doni të provoni.

Ju si avokat mbrojtës i të pandehurit të mitur, mund të kërkonti marrjen e provave që ju mendoni se janë të rëndësishme gjatë hetimit gjyqësor, bazuar në nenin 359 të KPP.

C. MBROJTJA NE GJYKATE

1.3.1 Alternativat e mbrojtjes

Kategoritë e teorive të mbrojtjes janë tre:

- Kërkimi i pafajësisë;
- Mbrojtja pohuese;
- Ngritja e dyshimit të arsyeshëm.

Për të zgjedhur formën e mbrojtjes duhet të konsultoni informacionin e marrë nga klienti juaj. Zgjedhja më e përshtatshme duhet të bazohet në shpjegimin që klienti i jep ngjarjes, në provat që gjykata pret të ketë, dhe në njohjen e kuadrit ligjor penal për të miturit.

Përpara se t'i sugjeroni klientit tuaj nëse duhet të pranojë një gjykim apo jo, ju jeni të detyruar t'i përcaktoni klientit tuaj se sa i fortë është qëndrimi i gjykatës ndaj rasteve të ngjashme, pavarësisht mbrojtjes suaj, dhe ta njihni klientin tuaj me zgjidhjet që i janë dhënë më parë rasteve të tilla. Nëse klienti juaj vendos që nuk do të gjykohet, atëherë ju duhet të ndryshoni strategjinë në një negociim të mundshëm për një kërkesë për falje.

➤ *Kërkimi i pafajësisë*

Bazuar nënën 328 të KPP, prokurori mund të vendosë pushimin e akuzës dhe të çështjes në çdo fazë të procesimit ndër të tjera kur:

- del qartë se fakti nuk ekzistonte;
- ekziston një shkak që e shuan veprën për të cilën ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;
- del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet që e ka kryer ai.

Duke marrë në konsideratë parashikimet e këtij neni, ju si avokat mund të kërkoni pafajësinë përgjithësisht kur klienti i mitur tregon se ai nuk ka qenë në vendin e ndodhjes së krimit, ose ka qenë atje por nuk ka marrë pjesë në të dhe policia e ka ngatërruar, e kështu pa të drejtë i ka ngritur akuzën. Mund ketë ndodhur gjithashtu që i gjithë

krimi i supozuar nuk ka ndodhur fare në të vërtetë, apo ka ndodhur shumë ndryshe nga ajo që pretendon akuza dhe për këtë arsye klienti i mitur nuk ka lidhje me versionin e paraqitur nga organi i akuzës.

➤ *Mbrojtja pohuese*

Mbrojtja pohuese në përgjithësi kërkon dhënien e më shumë sqarimeve nga klienti juaj dhe në këtë rast nuk mund të pretendohet më që klienti nuk e ka kryer veprën penale, por mbrojtja do të përqëndrohet në fakte të tjera si psh. që klienti juaj nuk mund të shpallet fajtor për arësye të gjendjes së tij mendore apo për shkak të ekzistencës së arsyeve dhe justifikimeve të caktuara. Një mbrojtje pohuese mund të kërkoj nga ana juaj si avokat paraqitjen e provave të cilat arrijnë një lloj standarti provueshmërie ndryshe nga rastet e tjera kur klienti juaj mund vetëm të përmendi fakte dhe rrethana për të cilat barra e provës si me provimin ashtu dhe me mosprovimin e tyre i mbetet organit të akuzës.

Mbrojtjet pohuese mund të bëhen shpesh në rastin e veprimit të klientit të mitur në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, parashikuar nga neni 19 i KP, në të cilin parashikohet mosmbajtja e përgjegjësisë penale jo vetëm për veprimet që personi kryen për të mbrojtur veten e tij, por edhe kur ai vepron në mbrojtje të personave të tretë. Mbrojtje pohuese mund të bëhet edhe në rastet kur personi është i shkarkuar nga përgjegjësia penale kur vepron për mbrojtjen e pronës, parashikuar në nenin 20 të KP, si veprime të kryera në kushtet e nevojës ekstreme.

Mbrojtje pohuese mund të bëhen edhe duke sjell si shkak keqkuptimin e situatës, futjes në kurth, moskompetencës - të moskuptuarit për shkak të qënies i mitur apo kur i mituri ka vepruar në kushtet e intoksikimit.

➤ *Ngritja e dyshimit të arsyeshëm*

Në disa raste mungesa e provave kundër klientit tuaj të mitur mund të jetë thelbi i gjithë mbrojtjes tuaj, bazuar në parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar në nenin 30 të Kushtetës së R.Sh. dhe nenin 4 te

KPP, dhe si rrejdhojë barra e provës bie mbi organin e akuzës.

Bazuar në parimin e prezumimit të pafajësisë është e rëndësishme të kujtoni që ju si avokat nuk duhet të provoni pafajësinë dhe se ju mund të bëni një mbrojtje efektive duke treguar që prokurori ka dështuar në provimin e momenteve të rëndësishme të rastit duke synuar klasifikimin e rastit të klientin tuaj jashtë çdo dyshimi të mundshëm, gjë që është elementi kryesor për të vendosur nga ana e gjykatës.

Standarti i provimit “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm” është niveli më i lartë i të provuarit në sistemin tonë gjyqësor dhe argumenti juaj gjatë gjykimit duhet ta kujtojë gjykatën se barra e provës qëndron në mënyrë ekskluzive tek prokurori. Disa mbrojtje ndonjëherë dështojnë pikërisht se ky fakt nuk theksohet, pasi supozohet se gjyqtari apo trupi gjykues e dinë këtë gjë dhe u duket e pavend ta parashtrojnë atë. Kjo ndodh edhe për një arsye tjetër; pasi avokatëve u duket se po u japin leksione gjyqëtarëve për një gjë kaq bazike. Në vazhdim të kësaj, është e këshillueshme që ju të gjeni mënyra për të ngritur argumente për dyshimin e arsyeshëm kryesisht në pjesën e hapjes dhe të mbylljes së fjalës tuaj.

1.3.2 Gjykimi

Mbrojtja e realizuar quhet ajo që e përfshin edhe gjykimin e rastit. Pavarësisht predispozitës për të ndihmuar rastet e minoreneve, është detyrë e mbrojtjes të merret me realizimin e të gjitha fazave të tjera të cilat të çojnë drejt gjykimit të çështjes.

Forma më e mirë për të qenë të sukseshëm në gjykim, është që ta merrni seriozisht rastin që në momentin që ai prezantohet. Gjatë gjykimit duhet të jeni të përgatitur të përballeni me të gjitha surprizat me të cilat mund të ndesheni gjatë gjykimit. Përgatitja dhe organizimi janë çelësi i suksesit të çdo profesionisti. Për të qenë i sukseshëm mbështetuni tek experienca e njerëzve që janë më kompetent dhe që kanë më shumë përvojë në fushën e mbrojtjes. Është e rëndësishme që

në fazën e gjykimit të tregoni përpara gjyqtarit apo trupit gjykues se e respektoni dhe se jeni partnerë me klientin tuaj. Gjykata do të marrë nga ju një stimul nëse duhet ta ndihmojë apo jo klientin juaj.

➤ *Ç' duhet të keni parasysh kur ndesheni me rastin tuaj të parë*

- *Rregullat proceduriale penale dhe rregullat e prezantimit të provave në procesin penal edhe për të miturin. Ju duhet të njihni mirë të drejtën procedurale dhe materiale penale që të përfaqësoni në mënyrë të përshtatshme të miturin dhe të dini të reagoni në momentin e duhur kundrejt prokurorit sidomos në rast se ai përdor prova të palejueshme.*
- *Si të veproni në lidhje me provat standarte. Konsultoni një ekspert ose materiale të shkruara që t'ju instruktojnë se si duhet të menaxhohen standartet në prova si psh. duke bërë refuzimin e tyre dhe ngritjen e dyshimeve në lidhje me autenticitetin, etj.*
- *Si të bëni një kërkesë për apel. Duhet që gjithmonë të mendoni paraprakisht për një apelim të ardhshëm të rastit tuaj. Njihuni me kërkesat dhe kushtet e kryerjes së ankimit, apelit, rekurseve dhe afatet përkatëse parashikuar në nenet 410-448 të KPP, në mënyrë që të jeni i përgatitur me të gjitha materialet në momentin që do të bëni kërkesën.*

Përveç rregullave të mësipërme, për shkak të specifikës që ka klienti juaj i mitur, duhet patjetër të mbani parasysh përgjegjësinë që ju keni për këshillimin e të pandehurit të miturit dhe për invokimin e qenies së tij si subjekt i mbrojtjes së posaçme, parashikuar në nenin 54 të Kushtetutës së R.Sh. duke u përqëndruar në zbatimin e të drejtave themelore të tyre gjatë procesit penal.

➤ *Deklaratat e Hapjes dhe Parashtrimet Hyrëse*

Edhe pse mund të mos jetë praktikë e punës suaj të përditshme është e këshillueshme që avokati të përgatisë një deklaratë hapjeje.

Kjo praktikë bën që seanca juaj edhe pse me subjekt një të mitur, të merret seriozisht nga trupi gjykues.

➤ *Parashtrimi hyrës i prokurorit*

Bazuar në nenin 356, pika 1, të KPP, prokurori dhe i dëmtuari akuzues janë të parët që parashtrojnë faktet në mënyrë të përmbledhur, të cilat përbëjnë objektin e akuzës dhe tregojnë provat që duhet të shqyrtohen. Ky është një moment i rëndësishëm. Dëgjoni me kujdes dhe mbani shënime. Në deklaratën e tij të hapjes ju mund të zbuloni disa nga provat dhe dëshmitarët që ai do të përdorë, dhe mund të vëzhgoni gjatë gjyqimit nëse ai i përmbahet premtimeve të tij apo jo. Nëse jo, ju do të keni mundësinë të nxirrni në pah dështimin e tij në zbardhjen e rastit tuaj. Gjithashtu, nëse besoni se disa nga pohimet e tij në deklaratën e hapjes nuk mund të realizohen mund të provoni ta kundërshtoni atë që në fillim. Për këtë duhet të jeni të sigurt që të mund të insistoni në faktin që të gjitha provat e përmendura të shpjegohen në detaje, në mënyrë që gjyqtari të mos gjykojë paraprakisht që ato duhet të përjashtohen.

➤ *Parashtrimi hyrës i mbrojtjes*

Bazuar në nenin 356, pika 2 e KPP, mbrojtësi i të pandehurit ka të drejtë të tregojë faktet që synojnë të provojnë dhe provat që duhet të merren. Kjo përbën në vetevete edhe momentin tuaj për të prezantuar klientin përpara gjyqtarit në formën e zgjedhur prej jush. Parashtrimi apo deklarata juaj duhet të jetë e shkurtër, e qartë dhe e drejtpërdrejtë. Kur ta përgatisni, mbani parasysh gjyqtarin apo antarët e trupit gjykues, karakteristikat e tyre, nëse jeni familjar me mënyrën e tyre të sjellurit dhe e të gjykuarit. Mundohuni ta memorizoni parashtrimin tuaj me qëllim që të mund ta paraqesni atë sa më fuqishëm para gjykatës. Një gjyqtar do ta vlerësonte konçizitetin. Parashtrimi juaj duhet të përmbajë teorinë tuaj të mbrojtjes dhe temën e argumentit tuaj. Përpiquni ta fokusoni parashtrimin tuaj të hapjes në 3 pika kryesore, të cilat lidhen me teorinë dhe temën tuaj. Kjo formë prezantimi do ta fuqizojë argumentin tuaj dhe do ta bëjë atë më të lehtë për tu kujtuar nga të

tjerët. Përgatitja e strukturuar në 3 pika, ju siguron që parashtrimi juaj të ketë edhe një pikë mbylljeje të formuar mirë.

Mos harroni të bëni në këtë moment kërkesat paraprake në bazë të nenit 354 të KPP, në lidhje me juridiksionin, kompetencën, me bashkimin apo ndarjen e procedimeve, me legjitimimin e paditësit apo të paditurit civil nëse ka, pasi ato nuk mund të parashtrihen më vonë n.q.s nuk janë ngritur menjëherë pas legjitimitit të palëve. Gjatë këtij procesi nuk lejohen replika apo kundërshtimet.

Jini i kujdesshëm të mos premtoni shumë në parashtrimin tuaj hapës, të mos ekzagjeroni me faktet apo provat. Gjyqtari apo trupi gjykues do të kujtojë ato çfarë keni premtuar dhe do t'i marrë për bazë neglizhencat e tuaj në vërtetimin e tyre. Prokurori gjithashtu do të përpiqet t'ju tregojë se nuk jeni treguar korrekt me provat e premtuara.

1.3.3 Provat e marra jo konform ligjit

Për të shmangur përdorimin nga ana e prokurorit të provave të cilat nuk janë autentike apo të pranueshme para gjykatës, bëhuni shumë i qartë në evidentimin e rregullave të vendosura nga Kushtetuta, neni 32, pika 2, ku parashikohet se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme dhe nga legjislacioni procedural penal neni 151, pika 4, ku parashikohet se provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Bazohuni në këto rregulla në mënyrë që të mund të ngrini kundërshtimet tuaja ndaj provave të papërshtatshme të paraqitura.

(Për më tepër informacion mbi krijimin e kundërshtimeve shih në faqe 43-45 ku mund të gjeni një listë të tyre)

Ka shumë elemente, që duhet të mbani ndërmend ndërkohë që i përgjigjeni provave të përdorura nga akuza:

➤ **Besueshmëria**

Që të jenë të pranueshme, provat duhet të jenë të besueshme. Për disa prova fizike, prokurori do të përpiket të krijojë një grup pyetjesh për dëshmitarin me qëllim që të zbulojë se kush nga ato do të quhen të pranueshme. Provat fizike apo rezultatet që kanë lidhje me gjyqësorin kanë në thelb krijimin e një sërë procedurave, në thelb të cilave është zbulimi nëse provat janë origjinale dhe jo të keqpërdorura apo të transformuara. Pas pyetjeve të prokurorit dhe para se provat të pranohen, ju keni mundësinë të bëni pyetjet tuaja për të testuar besueshmërinë. Kurdo të keni mundësi ju duhet të provoni vërtetësinë e provave dhe gjithçka që mund të çënojë ato duke i bërë të pavlefshme.

➤ **Provat e papranueshme**

Rregullat e provës. Rregullat për vërtetimin e provave janë të ndryshme dhe komplekse. Gjatë hetimit dhe procesit të gjyqimit, bazuar në Kushtetutë dhe në Kodin e Procedurës Penale si dhe në rregullat e juridiksionit tuaj mbi provat, vlerësoni çdo objekt apo pjesë informacioni që prokurori përpiket të ofrojë për të bërë një refuzim. Ndoshta argumenti më zakonshëm i përdorur për papranueshmërinë e një prove është se prova është thjesht një thashethem apo bazohet në një paragjykim. (*Shih listën e kundërshtimeve në fq.43-45*)

➤ **Provat Shkencore dhe Ligjore**

Mos hezitoni përpapa provave shkencore të prezantuara nga prokurori. Nëse ai ju ofron prova të bazuara në metoda të reja shkencore, ju mund të argumentoni që ato janë të papranueshme duke u mbështetur në standartet e besueshmërisë të përdorura në raste të ngjashme. Nëse provat pranohen ju duhet dhe mund t' i jepni gjyqtarit apo trupit gjykues arsye për të ngritur dyshime mbi metodat shkencore të përdorura dhe rezultatet e tyre. Ka shumë burime që mund t' ju ndihmojnë të mësoni dhe të sfidoni provat shkencore. Këtu përfshihet edhe libraria online e cila është krijuar nga një partneritet

midis National Association of Criminal Defenses Lawyer dhe National Legal Aid Defender Association (www.nlada.org/Deffender/forensic.)

Zakonisht prokurori i prezanton provat e tij ligjore shkencore përmes një eksperti dhe aktit të ekspertimit, parashikuar në nenin 184 -185 të KPP. Ju duhet të përgatiteni për bërjen e pyetjeve shkencore mbi procedurën dhe informacionin që rezulton nga dëshmia e ekspertit. Mund të ndodhë që ky ekspert të përfaqësojë opinionin e një grupi të vogël ekspertesh me shpjegimin e tij shkencor. Ose mund të ndodhë që dëshmia e tij të jetë në kundërshtim me përmbajtjen e një materiali të cilin ai është i gatshëm ta njohë si një dokument bazë.

Ju duhet të njiheni edhe me standartet, manualët, protokollet, mjetet matëse dhe laboratorin e prokurorisë për të parë nëse ato garantojnë standartet e nevojshme profesionale dhe respektojnë procedurat.

Një gabim i vogël në këto elemente mund të bëhet arsye që trupi gjykses të dyshojë në saktësinë e provave të paraqitura nga prokurori.

1.3.4 Mungesa e provave

Ju mund të vini në pah përpara gjyqtarit faktin e mungesës së provave shkencore nga ana e prokurorit si një burim për “dyshimin e arsyeshëm”, megjithatë jini të kujdesshëm të mos prezantoni argumentin e papërshtatshëm të “mungesës së provave”, nëse keni mundësi fokusohuni në pjesën që akuza ka mjetet e nevojshme për të nxjerrë prova shkencore dhe ka vendosur të mos i përdorë ato. *P.sh. në një rast plagosjeje, prokurori nuk ka përdorur testin që vërteton gjuajtjen me armë nga klienti juaj. Në këtë rast ju mund të merrni informacion në lidhje me mjetet që ndodhen në laboratorin e policisë me qëllim që të mund të mbroheni me faktin se një rrethanë e rëndësishme nuk është vërtetuar pa prezantuar faktin që prokurori ka pasur të gjitha mjetet për ta realizuar atë.*

1.3.5 Dëshmitarët e mbrojtjes dhe prezantimi i provave

➤ *Dëshmitarët e Mbrojtjes*

Është e këshillueshme të mos jeni përfundimtar për sa i përket vlerësimit se cilët dëshmitarë do të përdorni, të paktën nuk duhet ta merrni këtë vendim derisa të keni dëgjuar të gjitha provat e prezantuara nga prokurori. Mendohuni paraprakisht nëse është e udhës që të përdorni dëshmitarët që keni. A mund t'i prezantoni provat në një formë tjetër? Mos e nënvlerësoni kurrë aftësinë e një dëshmitari për t'i përkeqësuar gjërat.

➤ *Përgatitja e dëshmitarit për të dëshmuar*

Edhe pse mund të mos e keni vendosur ende nëse do të përdorni një dëshmitar apo jo përgatitini ata për një prezantim dhe ekzaminim të mundshëm nga prokurori. Mendoni për pikat që do të ekzaminoni dhe pyetjet që mund t'ju bëhen nga prokurori. Gjithashtu pajiseni dëshmitarin me njohuritë mbi objektin dhe kufijtë e dëshmisë së tij sipas nenit 153 të KPP, mbi rregullat që e bëjnë të vlefshme dëshminë e tij parashikuar në nenin 154, "Dëshmia indirekte", si dhe mbi detyrimet e dëshmitarit sipas nenit 157 të KPP.

➤ *Mos harroni:*

- *Mbajeni dëshmitarin në pritje për një kohë sa më të shkurtër të mundshme.*
 - Mos i bëj shumë pyetje, mund të krijoni konfuzion apo kushte që dëshmitari të kontradiktojë veten e tij;
 - Numri i shumtë i dëshmitarëve mund ta tërheqin vëmendjen e gjyqtarit nga pikat kryesore.
- *Bëj pyetje me fund të mbyllur.*

Nëqoftëse e keni përgatitur dëshmitarin, ai dhe ju duhet të dini se çfarë pyetjesh vijnë në vazhdim.

Kujdes!

Mos bëj pyetje të hapura të cilat mund ta bëjnë dëshmitarin konfuz dhe kontradiktor.

- *Mbaj parasysh qëllimin e secilës pyetje.*

Nëse nuk jeni duke marrë informacionin që prisnit, ribëni pyetjen deri sa informacioni të jetë ai i kërkuari. Nëse dëshmitari juaj nuk mban mend përgjigjen, vëriini atij në dispozicion stimuj të tillë si dokumenta apo prova fizike, të cilat mund t'ia rifreskojnë memorien.

- *Ndihmoni dëshmitarin që të jetë sa më dinamik dhe ilustrativ që të tjetër e mundur.*

Përgatitja e nje mbrojtjeje të strukturuar dhe me një skemë të qartë zhvillimi mund t'ju ndihmojë të specifikoni provat dhe dëshmitarët e nevojshëm. Ju mund të përdorni edhe përmbledhjen e fakteve dhe informacioneve të dhëna nga dëshmitari deri në një moment të caktuar për të lehtësuar vazhdimin e procesit të dhënies së dëshmisë. Një metodë ilustrative mund të ishte gjithashtu edhe vizatimi i skenës së krimit, apo të vepruarit e dëshmitarit në të njëjtën mënyrën si dikush veproi në skenën e krimit, etj.

➤ *Marrja në pyetje e klientit të mitur në seancën gjyqësore*

Një nga pikat kyçe të mbrojtjes suaj është të vendosni nëse do të përfshini klientin tuaj në listën e dëshmitarëve apo jo.

Së pari ju duhet të vlerësoni faktin nëse gjyqtari e ka një arsye për të dyshuar mbi rastin tuaj. Në shumë raste, klienti përfshihet në listë vetëm nëse ka si qëllim të luftojë pikat e dobta të akuzës së prokurorit.

Së dyti ju duhet të vlerësoni përfitimet në kontrast me humbjet që mund të ndodhin, kjo përfshin jo vetëm dëshminë e klientit tuaj, por edhe qëndrimet e tij, të cilat mund të japin mesazhe të dyfishta.

Klienti i mitur mund të ndihmojë në fitoren e çështjes vetëm nëse mund të prezantojë një provë të cilën mund ta japë vetëm ai. Por

kujdes, nëse trupi gjykyes dyshon për ndonjë fakt, rrethanë apo të dhënë e cila do të rezultonte në dyshimin se provat e sjellja nuk janë të vërteta, e gjithë kjo mund të çonte në dështimin apo humbjen e çështjes.

Gjithashtu, është e rëndësishme që ju të vlerësoni nëse klienti mund të dëmtojë çështjen pasi nuk mund ta përballojë ekzaminimin e tërthortë nga prokurori gjatë ballafaqimit me të. Në një rast të tillë, klienti i mitur është më mirë të mos dëshmojë.

➤ **Këshillimi nga avokati i të miturit të pandehur kur ai do të dëshmojë vetë në seancë**

Bazuar në nenin 166 të KPP, i pandehuri pyetet në një procedim n.q.s. bën kërkesë vetë ose kur u kërkohet dhe ata japin pëlqimin për këtë. Lidhur me këtë, pasi keni vendosur që klienti i mitur të flasë vetë në seancë gjyqësore, bëni me të prova paraprake dhe jepini këshilla për procesin e dëshmimit, për të cilat mbështetuni në këto çështje kyçe përveç konsideratave të tjera si:

- Shpjegimin e avantazhit dhe rëndësisë së dëshmisë së tij në çështje përkatëse, duke theksuar edhe rëndësinë që ka tregimi i versionit të tij të historisë;
- Informimin e klientit të mitur që dëshmia e tij është shumë e rëndësishme si provë dhe që nuk mund të jepet nga asnjë dëshmitar tjetër;
- Mbajtjen parasysh të karakterit të klientit të mitur; nëse ai ka karakter të vështirë, (kjo mund ta bëj prezantimin e tij jo shumë të vlefshëm) apo nëse ai duket i besueshëm në ato që thotë duke konsideruar këtu aftësinë për të folur në publik, për të vendosur kontakte me sy, dhe për të respektuar një përmbajtje të paracaktuar;
- Mbajtjen parasysh të rrethanës kur i mituri ka pohuar diçka gjatë veprimeve hetimore, të cilën do ta kundërshtojë;
- Mundësinë që ekziston që klienti juaj të luaj me pikat e forta dhe të dobta të prezantimit të prokurorit.

Nëse vendosni që klienti juaj do të dëshmojë, përgatiteni atë, tregojini pyetjet që do t'i bëni dhe formën e përgjigjes që duhet të japë. Bëni ç'është e mundur që klienti juaj të shfaqet i sigurt, të flasë lirshëm dhe të përgjigjet sipas parametrave të përcaktuara për të shmangur kështu mundësinë e një ekzaminimi të mëtejshëm.

Ju duhet të përgatisni klientin tuaj për pyetjet ekzaminuese që do të bëjë prokurori dhe të jepni versione të ndryshme përgjigjesh.

Pavarësisht nëse do të dëshmojë apo jo, klienti juaj duhet të vijë në gjykatë i veshur në mënyrë të përshtatshme dhe i pastër. Për këtë është e rëndësishme të vëzhgoni stilin e veshjes dhe paraqitjes së klientit tuaj gjatë kontakteve të mëparshme për të bërë sygjerimet e duhura për paraqitjen e tij në gjykatë. Kujdesuni për sjelljen e klientit tuaj në gjykatë, qëndrimin trupor dhe gjuhën e përdorur, të drejtuarin ndaj gjyqtarit/ve me "i/të nderuar".

➤ *Prezantimi i provave*

Mendoni se çfarë provash do përdorni dhe mënyrën e prezantimit të tyre duke treguar bazën ligjore përkatëse.

Mendohu mirë mbi atë që doni të prezantoni. Provat e mundshme përfshijnë dokumenta private, letra, regjistrime të dokumentave të ruajtura në kompjuter, regjistrime telefonike, prova fizike, etj.

➤ **Disa sygjerime në lidhje me prezantimin e provave do të ishin:**

• *Provimi i vërtetësisë së provave*

Për të vërtetuar provat e prezantuara para gjykatës, bëjini pyetje dëshmitarëve përmes së cilave mund të provoni vërtetësinë e tyre. Kërkojini dëshmitarit të provojë pohimet e tij. Në varësi të çfarë prezantohet nga dëshmitari; një letër, dokument apo diçka tjetër pyeteni atë: "A e njihni shkrimin? Si e keni siguruar dokumentin? Kush e bëri këtë dokument? Nga e dini ju këtë?"

- *Hapat e sigurimit të provës*

Ju duhet të prezantoni zinxhirin e sigurimit të provave fizike të analizuara në një laborator për të treguar se janë të provuara dhe jo të sajuara. Pyesni ekspertët se si kanë arritur provat deri në laborator dhe se si janë menaxhuar më pas.

- *Praktikoni mënyrën se si do t'i përdorni provat materiale*

Provat materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale, ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo kanë qenë objekt i veprimeve të pandehurit, produktet e veprës penale, çdo lloj pasurie që lejohet të konfiskohet si dhe çdo send që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes.

Duke qenë se të gjitha këto prova janë objekte konkrete, çdokush në sallën e gjyqit do të vinte re lehtësisht vështirësinë tuaj për të menaxhuar një provë materiale që dispononi. Prandaj, që të mos keni shqetësime, praktikoni paraprakisht se si duhet ta menaxhoni provën në sallën e gjyqit. Si do ta mbani armën? Çfarë do të bëni me letrat? Si do të përdorni provat e gjetura në një çantë të vjedhur? Merreni provën, kërkoni trupit gjykues apo dëshmitari të shohë provat sërish, përdorini në ekzaminimet tuaja. Përpiquni të përdorni provat e prokurorit për të theksuar fakte të rëndësishme që lidhen me çështjen tuaj.

- *Provat demonstrative.*

Gjatë gjykimit, provat demonstrative mund të jenë shumë të fuqishme. Sigurohuni paraprakisht se njihni format e përdorura, sipas juridiksionit tuaj, për të prezantuar këto prova në çështjen tuaj. (Në përgjithësi, ju duhet të etiketoni provat materiale, t'i kërkoni dëshmitarit të vendosë shënimet e duhura - si p.sh një X ku ishte duke qëndruar - dhe të merrni nga dëshmitari datën e saktë kur janë marrë këto prova). Modelet e mira ose diagramet që shërbejnë për matje kanë shumë mundësi të pranohen nga gjykata dhe janë shumë ndihmëse për gjykatën. Nëse do të paraqisni një provë demonstrative në sallën e gjyqit, sigurohuni që më parë të keni marrë lejen e kujtqdo që do të përfshihet qoftë edhe thjeshtë me një të prekur, në sallën e gjyqit. Shfaqja e respektit për dëshmitarin apo cilindro në sallën e gjyqit mund t'i

shërbejë vetëm pozitivisht çështjes suaj. Ju mund të përdorni si provë demonstrative edhe provat e dhëna nga shteti.

- *Ruani vazhdimësinë e paraqitjes së provave tuaja.*

Përgatit një listë për secilën provë materiale, duke identifikuar se çfarë është, numrin e letrës së firmosur, dhe nëse është pranuar si provë. Ky sistem do t'ju ndihmojë të jeni të organizuar dhe do të sigurojë që të gjitha provat tuaja materiale të bëhen pjesë e tërësisë së tyre.

Kujdes!

Nuk ndodh rrallë që të harrohet në hapin e fundit përdorimi i një dokumenti si provë.

- ***Marrja në pyetje nga prokurori i dëshmitarëve të mbrojtjes - Ekzaminimi i tërthortë***

Në bazë të nenit 361, pika 1 dhe 2 të KPP, prokurori ka të drejtë t'i drejtojë pyetje dëshmitarëve të mbrojtjes pasi avokati i mbrojtjes ka mbaruar së pyeturi, sipas pikës 3 të nenit 361 të KPP. Gjatë këtij procesi ndalohen pyetjet që ndikojnë keq në paanësinë e dëshmitarit, ose që synojnë në sugjerime. Në kuadrin e përshtatjeve të mësipërme është e rëndësishme që ju si avokat t'i kushtoni vëmendje pyetjeve të bëra nga prokurori gjatë ekzaminimit të tërthortë, në mënyrë që të mund të mendoni për një kundërshtim gjatë apo pas pyetjeve të prokurorit.

Mbroni dëshmitarët tuaj. Ju duhet të ndërhyjni nëse prokurori tallet me dëshmitarët tuaj ose tregohet shumë i ashpër me të. Edhe pse kundërshtimi juaj mund të jetë konform rregullave të vendosura në këtë mënyrë ju do të keni arritur diçka nëpërmjet ndërprerjes së ritmit të prokurorit.

1.3.6 Diskutimi përfundimtar dhe argumentet mbyllëse

Bazuar në nenin 378 të KPP, prokurori, mbrojtësi i të pandehurit dhe përfaqësuesit e palëve të tjera formulojnë dhe parashtrojnë

konkluzionet përkatëse. Gjatë këtij procesi palëve u lejohej të bëjnë replikë, megjithatë në çdo rast i pandehuri dhe mbrojtësi i tij duhet të kenë fjalën e fundit nëse e kërkojnë. Me mbarimin e diskutimit përfundimtar, kryetari i seancës e deklaroi të mbyllur shqyrtimin gjyqësor.

➤ **Argumentet mbyllëse të Prokurorit**

Kur prokurori përmbledh çështjen e tij, jini i vemendshëm të shënoni çdo argument të përdorur prej tij. Synimi juaj duhet të jetë të vërtetoni që ekziston një dyshim i arsyeshëm mbi fajësinë e klientit tuaj. Ndërsa ju dëgjoni përmbledhjen e tij, mendoni për format që do të nxjerrin në pah dështimet e tij në prezantimin e provave të premtuara në parashtrimet hyrëse të hapjes, theksoni dyshimet që vazhdojnë të mbeten të tilla edhe pas prezantimit të provave. Dëgjoni me kujdes për të kuptuar që prokurori nuk po i keqpërdor provat.

➤ **Argumentet mbyllëse të mbrojtjes**

Argumentet tuaja mbyllës nuk duhet të përcaktohen nga ato çfarë tha prokurori në argumentat e tij mbyllës pasi ju vazhdoni të luftoni për të njëjtën çështje që planifikuat dhe prezantuat në parashtrimet tuaja të hyrjes. Përsërisni teorinë dhe temën tuaj, për të vazhduar me tre pikat që prezantuat në deklaratën tuaj të hapjes. Referojuni provave të prokurorit dhe tuajave për të ngritur një dyshim të arsyeshëm. Nëse në provat e prokurorit ka pjesë që ju doni t'i adresoni, bëjeni një gjë të tillë, por mos lejoni atë ta modelojë çështjen sipas mënyrës dhe interesit të tij. Trego edhe një herë dështimet e prokurorit në përdorimin e provave. Bazuar në mundësinë që jep neni 378 i KPP, kërkonte gjithmonë të përfitoni për të thënë fjalën e fundit. Në këtë mënyrë, argumentat tuaj mbyllës janë ato çfarë gjykata do të dëgjojë për herë të fundit nga ju, kështu që kujdesuni që gjithçka të jetë e menduar, e mirë-përgatitur dhe e mirë-strukturuar.

1.3.7 Çështje të tjera për tu marrë në konsideratë

➤ *Kundërshtimet*

Një nga elementët më të rëndësishëm të një mbrojtjeje të mirë është përdorimi i kundërshtimeve, momenti dhe mënyra e bërjes së tyre. Kundërshtimi si instrument parashikohet në nenin 362 të KPP dhe mund të përdoret vetëm në procesin e marrjes së dëshmisë. Kundërshtimi mund të bëhet për të gjithë dëshminë ose për një pjesë të saj. Për këtë palët mund të përdorin si argument thëniet e mëparshme të dëshmitarit të cilat janë administruar nga prokurori apo policia gjyqësore dhe që janë pjesë e dosjes hetimore. E rëndësishme është të mbahet parasysh se kundërshtimet, pavarësisht se në vetvete nuk marrin vlerën e provës, ndikojnë tek gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur dhe përfshihen në fashikullin e shqyrtimit gjyqësor.

Bazuar në sa më sipër, mbrojtësit e çështjes duhet të kundërshtojnë kur vënë re se klienti i tyre po pyetet nga prokurori në mënyrë të papërshtatshme. Shprehni kundërshtimet tuaja në mënyrë të menjëhershme me qëllim që provat të mos arrijnë të merren në konsideratë nga gjykata. Nëse gjyqtari ju pyet që të tregoni bazën për kundërshtimin, ju do të keni një moment për të formuar argumentin tuaj.

Ji gjithmonë i kujdesshëm për të vlerësuar nëse bërja e një kundërshtimi mund të ndihmojë apo çënojë mbrojtjen tuaj. Edhe pse mund të vlerësoni se një kundërshtim do të dilte kundër rregullave, mirë është që të përdoret për të dhënë edhe një sinjal të parë për një apelim të mundshëm.

➤ *Kundërshtimet e mundshme – Lista e kundërshtimeve sipas situatës*

Bërja e kundërshtimeve të duhura mund të jetë e rëndësishme në mbrojtjen e çështjes së klientit tuaj dhe në një apelim të mundshëm. Një listë e kundërshtimeve që mund të përdoren gjatë gjykimit mund

të përmbajë kundërshtimet e mëposhtme:

Gjatë parashtrimit hyrës të prokurorit kundërshtimet mund të bëhen për:

- Provat mbrojtëse;
- Spekullime;
- Besimet personale;
- Fakte/ prova të paprovuara.

Kur prokurori bën pyetje ato mund të jenë:

- konfuze;
- pyetje të bëra dhe të përgjigjura më parë;
- pyetje të përbëra;
- kundërshtime të papërshtatshme;
- irrelevante, (pa lidhje me çështjen);
- argumentuese;
- që përmbajnë konkluzion;
- thashetheme;
- pyetje hipotetike të papërshtatshme;
- për dëshmitarë kompetente, jo për dëshmitarin e thjeshtë, të cilit i drejtohet;
- për provat e keqpërdorura;
- për privilegje;
- për testimë;
- për keqpërdorim të dëshmitarëve;
- për opinione personale;
- për paragjykime;
- me karakter spekulues.

Kur dëshmitari i përgjigjet pyetjeve, kundërshtimet mund të bëhen për:

- pranimin e një fakti që nuk është provuar;

- konkluzionet;
- mungesën e njohurive personale;
- pyetje të hapura;
- opinione personale;
- paragjykime;
- spekulime;
- prova më të mira;
- informacion irelevant;

Kur prokurori përdor prova materiale kundërshtimet mund të bëhen për:

- burimin;
- autenticitetin;
- hapat e sigurimit të provës;
- provat e papranueshme;
- kopje të certifikuara;
- prova më të mira;
- plotësime të nevojshme;
- lidhjen me çështjen;

Gjatë diskutimit përfundimtar dhe argumentave mbyllës të prokurorit kundërshtimet mund të bëhen për:

- komentimin e mbrojtjes si të pabazuar në prova;
- komentimin e mbrojtjes pa përfshirë dëshmitë;
- keqpërdorimin e provave;
- keqpërdorimin e ligjit;
- sulme personale ndaj klientit tuaj, vetë avokatit dhe zyrës së tij avokatore;
- opinionin personal të shprehur;
- paragjykimet;

1.3.8 Rastet e mos paraqitjes para trupit gjykues

Gjatë karrierës suaj, ju do të ndesheni me raste të mos paraqitjes në gjykatë të personave që duhet të ishin të pranishëm në seancën gjyqësore. Gjërat që duhet të konsideroni në këto momente varen nga fakti se cili është personi që mungon:

- **Në rast se mungon i mituri klient**

Klienti juaj duhet të jetë i pranishëm në fazën e gjykimit për të proceduar në lidhje me çështjen në ngarkim të tij. Nëse klienti juaj mungon, kërkoni nga gjykata pak kohë për të kuptuar arsyet pse ai nuk është i pranishëm dhe nëse ka ndonjë shkak ligjor bëjani të ditur gjykatës para se ajo të vendosë për të lëshuar një urdhër arresti për gjetjen e tij. Mos harroni që ju duhet të menaxhoni këtë situatë pa thyer rregullat e besueshmërisë. Në bazë të nenit 351 të KPP, gjykata pasi dëgjon palët mund të deklarojë mungesën e të pandehurit të mitur dhe të vazhdojë gjykimin duke e konsideruar atë të përfaqësuar nga mbrojtësi, prandaj sigurohuni të keni një prokurë e cila përcakton edhe përfaqësimin në mungesë, nëse do të ishte në interes të çështjes së klientit tuaj për të vazhduar procedimin.

Nëse i mituri mbahet i arrestuar në paraburgim sigurohuni që njoftimi i gjykatës të ketë shkuar dhe të jetë bërë i mundur transportimi i tij në për në gjykatë. Është për t'u theksuar se shpejtësia e gjykimit të çështjes jo vetëm ndihmon në respektimin e afateve të gjykimit të vendosura me ligj, por gjithashtu është shumë e rëndësishme në aspektin e gjendjes psikologjike të të miturit të akuzuar e të mbajtur në kushtet e paraburgimit.

- **Në rast se mungon prindi**

Prindi i të pandehurit të mitur nuk është parashikuar në legjislacionin tonë penal si një person që duhet të jetë patjetër i pranishëm në seancat gjyqësore kundër fëmijës së tij. Në nenin 35 të

KPP atij i garantohet prania tek i pandehuri i mitur në çdo shkallë të proçedimit kur kjo kërkohet nga i mituri dhe pranohet nga autoriteti proçedues. Por kjo nuk e bën seancën dhe proçedimin të pavlefshëm. E rëndësishme për ju si avokat është të siguroni praninë e prindit, pasi prania e prindit ndihmon të miturin dhe përbën një mbështetje për të gjatë proçedimit, dhe prania e tij është e rëndësishme nëse ai do të thirret si dëshmitar.

- **Në rast se mungon psikologu ekspert**

Sërisht bazuar tek neni 35 të KPP, të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë psikologjike në çdo shkallë të proçedimit. Megjithëse legjislatori nuk e ka zbërthyer se çfarë nënkupton ndihma psikologjike, në praktikën shqiptare të deritanishme ajo ka konsistuar kryesisht në prezencën e psikologut ekspert gjatë marrjes në pyetje të të miturit duke synuar kryesisht lehtësimin e komunikimit mes gjykatës, prokurorit dhe avokatit me të miturin e pandehur. Në rast se mungon psikologut ekspert, ju si avokat duhet t'i kërkoni gjykatës garantimin e pranisë së një psikologu si një ekspert i komunikimit dhe i shëndetit mendor që mund të lehtësojë gjëndjen e të miturit në seance dhe dhënien apo marrjen e informacionit nga ai.

- **Në rast se mungon një dëshmitar i mbrojtjes**

Në rast se mungon një dëshmitar i kërkuar nga mbrojtja dhe që është i nevojshëm atëherë kërkoni nga trupi gjykues që çështja të shtyhet në mënyrë që mbrojtja të bëhet sa më e fortë dhe e plotë. Në varësi të kushteve ju duhet të vendosni nëse çështja duhet të vazhdojë pa këtë dëshmitar apo duhet të lëshohet një fletë thirrje tjetër për të.

- **Në rast se mungon një dëshmitar i akuzës**

Ju si avokat duhet të mendoni në mënyrë strategjike. Në rast se

një dëshmitar i rëndësishëm i akuzës mungon, ju mund të kërkonti që procesi i gjyimit të vazhdojë dhe t'i jepet fund sa më shpejt që të jetë e mundur procesit, duke theksuar respektimin e afateve të parashikuara nga ligji. Por nëse ky dëshmitar i prokurorit nuk është aq i rëndësishëm dhe ju mund të përfitoni kohë nga shtyrja e gjyimit, atëherë mos e kundërshtoni kërkesën e prokurorit për të shtyrë seancën gjyqësore.

II. PËRMBLEDHJE DHE SHPJEGIM I KUADRIT LIGJOR TË APLIKUESHËM GJATË MBROJTJES SË TË MITURIT

2.1. Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Asnjë fëmije të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe duhet të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve si çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar është pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë sipas nenit 122 të Kushtetutës së R.Sh.

Neni 37

Shtetet Palë sigurojnë që:

- a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepen për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç;
- b) Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër;
- c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë;

që të kihen parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;

- d) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose nj autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.

Neni 40

1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmijë të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.

2. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, Shtetet Palë kujdesen në veçanti që:

- a) Asnjë fëmijë të mos jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer;
- b) Çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën garancitë që vijojnë:
- I) Të prezumohet i pafajshëm derisa të provohet pafajësia ligjërisht;
- II) Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose nga çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij;
- III) Çështja e tij shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë

gjqësore kompetence, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme dhe kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

- IV) Të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor; të pyeten ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta.
- V) Në qoftë se vendoset se ka shkelur ligjin penal, të bëjë ankim kundër këtij vendimi si dhe çdo masë të marrë si pasojë, para një autoriteti ose një instance gjyqësore kompetente më të lartë, të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me ligjin.
- VI) Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret.
- VII) Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës.

3. Shtetet Palë përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal dhe në veçanti:

- a) Përcaktojnë një moshë minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal;
- b) Marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore.

4. Parashikohen dispozita të ndryshme, siç janë kujdesi, orientimi dhe kontrolli; këshillat; periudha e provës; kujdesi në familje; programet e edukimit të përgjithshëm dhe profesional dhe zgjidhje të tjera, veç atyre institucionale, për t'u siguruar fëmijëve një trajtim në përputhje me mirëqenien e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit.

2.2 Respektimi i normave procedurale

Dispozitat procedurale, neni 2 KPP, caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.

2.3 Arrestimi në Flagrancë

Këto dispozita janë theksuar me qëllim që të tërheqin vëmendjen e avokatëve për tu bazuar tek ato, por jo vetëm, edhe në mënyrë që të shmangin sa më shumë të jetë e mundur masat e sigurisë me arrest në burg për të miturit.

Neni 255 i KPP - detyrat e prokurorit dhe të policisë gjyqësore kur i mituri arrestohet në flagrancë ose ndalohe

“Kur i arrestuari ose i ndaluari është i mitur, lajmërohet detyrimisht prindi ose kujdestari.

Kur i arrestuari ose i ndaluari është i mitur, prokurori mund të urdhërojë që ai të mbahet në ruajtje në banesën e tij ose në një vend tjetër të ruajtur”.

Kjo është një mënyrë tjetër për të lehtësuar të miturin që është arrestuar në flagrancë nga policia. Në këtë rast prokurorit i jepet e drejta që ta nxjerrë të miturin nga burgu dhe të urdhërojë që ai të qëndrojë në shtëpinë e vet ose në një vend tjetër të ruajtur, që mund të jenë të afërmit apo institucionet e edukimit të të miturve.

Megjithë përcaktimin e saktë ligjor se masa e sigurisë me arrest në burg është një masë ekstreme dhe përdoret kur të gjitha masat e tjera janë të papërshtatshme, në praktikën tonë është vënë re një praktikim i shpeshtë i kësaj mase ndaj të miturve.

Praktika tregon se rrallë herë gjyqtarët argumentojnë në vendimet e tyre se përse në rastet konkrete me të pandehur të mitur të gjitha masat e tjera të sigurisë janë të papërshtatshme dhe vetëm arresti në burg përmbush qëllimet e sigurisë.

2.4 Masat e Sigurisë

Neni 229 i KPP - caktimi i masave të sigurimit për të miturin

“Kur i pandehuri është i mitur, për caktimin e masave të sigurimit (izolimim), gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete”.

Është fjala për të miturit që akuzohen se kanë kryer vepra penale, për të cilat gjykata duhet të vendosi nëse do të procedohen në gjendje të lirë apo si të paraburgosur. Për të miturit caktohet një kriter që gjykata duhet ta mbajë parasysh në çdo rast konkret. Kur bëhet fjalë për paraburgimin e të miturit, gjykata duhet të shikojë mundësinë që të mos ndërpritet procesi edukativ, siç mund të jetë shkolla, kurset etj.

Neni 230 i KPP - mosarrestimi i të miturit për kundërvajtje penale

“Të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundërvajtje penale”.

Kundërvajtjet janë vepra me rrezikshmëri të vogël që dënohen me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Për këto lloj veprash i mituri nuk mund të arrestohet edhe kur kapet në flagrancë.

Neni 249 i KPP - ankimi kundër masave të sigurimit

“Kundër vendimit të gjykatës për vendosjen e një mase sigurimi mund të bëhet ankim në gjykatën më të lartë”.

Neni 260 i KPP - Revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit

Masat e sigurisë mund të revokohen kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre ose mund të zbuten kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet.

Këto dy nene janë theksuar për të tërhequr edhe një herë vëmendjen e avokatëve për të bërë të gjitha përpjekjet që për të miturit të aplikohet sa më pak të jetë e mundur masa e sigurisë me arrest në burg.

2.5 Hetimi

Neni 28 i Kushtetutës së R.Sh

“...Personi të cilit i është hequr liria duhet të njoftohet se nuk është i detyruar të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t’i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij”.

Lidhur me këto dy dispozita të fundit, në pjesën e materialit që flet për përvojat e mbledhura nga puna e avokatëve, ka më poshtë një sqarim më të hollësishëm, por ajo që mund të theksohet është se punonjësi i policisë që bën shoqërimin duhet të dokumentojë menjëherë me shkrim veprimet e tij, të paralajmërojë personin e shoqëruar për të drejtën që ka për të mos bërë deklaratë dhe t’i japë mundësi të njoftojë avokatin e tij dhe prindërit në rastin e minorenit.

Neni 24 i KPP- (Funksonet e prokurorit),

Neni 30 i KPP - (Funksonet e policisë gjyqësore),

Neni 277 i KPP -(Organet e ngarkuara për hetimet paraprake)

Ushtrimi i ndjekjes penale kryhet nga prokurori i cili bën hetime, kontrollon hetimet paraprake dhe ngre akuzën në gjykatë. Hetime, përveç detyrave të tjera, kryen edhe policia gjyqësore. Prokurori është ai që drejton hetimet.

Neni 293 KPP - referimi i veprës penale te prokurori

Me marrjen e njoftimit për një veprë penale policia gjyqësore pa vonuar i referon me shkrim prokurorit elementët thelbësorë të faktit dhe elementë të tjerë që janë mbledhur ndërkohë dhe vazhdon të kryejë detyrat e saj ligjore.

Neni 295 KPP - identifikimi i personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet

Një nga këto detyra është edhe identifikimi i personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet. Në rastet kur personi refuzon të identifikohet ose jep të dhëna dhe dokumente identifikuese që dyshohet se janë të rreme, policia gjyqësore ka të drejtë ta mbajë personin në zyrat e saj për aq kohë sa i duhet për të bërë identifikimin, por jo më shumë se 12 orë.

Në praktikë janë të shpeshta rastet e shkeljes së këtyre përcaktimeve ligjore, prandaj avokati duhet të ketë parasysh tre momente kryesore që dalin nga kjo dispozitë: së pari i pandehuri mbahet në zyrat e policisë gjyqësore, pra jo në ambjente të tjera, së dyti mbahet për jo më shumë se 12 orë dhe së treti mbahet vetëm kur ka refuzuar të identifikohet ose dyshohet se ka dhënë të dhëna identifikuese të rreme.

Neni 45 i Ligjit nr.8553 dt. 25.11.1999 “Për policinë e shtetit”

- Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në zyrat e policisë ose organin urdhërdhënës, në kushtet dhe rastet e parashikuara nga neni 27 i Kushtetutës.
- Personat e shoqëruar, të cilët nuk dyshohet se kanë kryer një veprë penale, trajtohen në kushte të dallueshme nga ndalimi apo arrestimi dhe në çdo rast shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.
- Personi i shoqëruar gëzon të gjitha të drejtat e njohura nga neni 28 i Kushtetutës.
- Për shoqërimin e personave, punonjësi i policisë bën dokumentimin e veprimit dhe njofton menjëherë eprorin e tij ose organin e interesuar për sqarimin e çështjes.

Neni 12 KP - Moshë për përgjegjësi penale

“Përgjegjësi penale ka personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç”.

“Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç”.

Në zbatimin e kësaj dispozite duhet të mbahen parasysh këto rregulla:

Veprat penale ndahen në krime dhe kundërvajtje, sipas përcaktimit që bëhet në dispozitën përkatëse të Kodit Penal.

Kundërvajtjet penale janë vepra me rrezikshmëri të vogël dhe dënohen me gjobë ose burgim nga pesë ditë deri në dy vjet, kurse krimet dënohen me gjobë ose me burgim nga pesë ditë deri në 25 vjet ose me burgim të përjetshëm.

Të miturit që nuk kanë mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç nuk mund të procedohen penalisht për të dy llojet e veprave penale. Përgjegjësia për kundërvajtjet penale fillon në moshën 16 vjeç.

Neni 41 KPP - Verifikimi i moshës së të pandehurit

Në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, kur ka arsye për të besuar se i pandehuri është i mitur, organi procedues bën verifikimet e nevojshme dhe kur është rasti urdhëron ekspertimin.

Kur edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit, mbeten dyshime për moshën e të pandehurit, supozohet se ai është i mitur”.

Dispozita, siç shihet, ngarkon organin e procedurës me detyrimin për të bërë verifikimet e nevojshme, por sigurisht që edhe avokati i të pandehurit duhet të jetë i vëmendshëm ndaj përcaktimit të saktë të moshës dhe për më tepër është pjesë e detyrës së tij të bëjë edhe verifikime personale të pavarura nga organi procedues.

Neni 290 i KPP - Rethanat që nuk lejojnë fillimin e proçedimit

Proçedimi penal nuk mund të fillojë, dhe në qoftë se ka filluar duhet të pushojë, kur personi nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale”.

Në këto tre dispozita të Kodit Penal dhe të Kodit të Proçedurës Penale shprehet kujdesi për të përjashtuar të miturit nga përgjegjësia penale, në varësi të rëndësisë së veprës penale që kanë kryer.

Deri në moshën 14 vjeç ata nuk mund të proçedohen penalisht për asnjë lloj vepre penale. Kur mbushin moshën 14 vjeç ata përgjigjen vetëm për krime dhe kur bëhen 16 vjeç përgjigjen edhe për kundërvajtje penale.

Organet e proçedimit penal (Policia Gjyqësore, Prokuroria dhe Gjykata) duhet të verifikojnë me kujdes moshën e të miturit, duke u bazuar në dokumentet e gjëndjes civile, dhe kur nuk ka të tilla duhet të bëjnë verifikimet e nevojshme dhe të caktojnë ekspert për përcaktimin e moshës. Kur ky përcaktim nuk mund të bëhet i saktë dhe mbetet e dyshimtë në se i mituri e ka mbushur moshën ose jo për veprën që akuzohet, ai do të konsiderohet i mitur dhe proçedimi do të fillojë ose jo në varësi të veprës për të cilën hetohet. Në qoftë se konstatimi i moshës bëhet pas fillimit të proçedimit penal, çështja duhet të pushohet në bazë të nenit 328 të K.Pr.Penale.

Neni 296 i KPP - Të dhëna mbi personin ndaj të cilit zhvillohen hetimet

Oficerët e policisë gjyqësore marrin të dhëna nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të tij. Kur mbrojtësi nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, policia gjyqësore kërkon nga prokurori që të caktojë një mbrojtës tjetër.

Deklaratat që mund të merren nga personi ndaj të cilit po zhvillohen hetime nuk lejohet të përdoren në gjykim.

Neni 302 i KPP - Ndihma e mbrojtësit

Mbrojtësi i personit ndaj të cilit zhvillohen hetime ka të drejtë të asistojë në kontrollet dhe verifikimet e ngutshme në vend, por pa patur të drejtën që të lajmërohet paraprakisht.

Neni 37 i KPP - Deklarimet që tregojnë vetëpërgjegjësi

Kur një person që nuk ka marrë ende cilësinë e të pandehurit, përpara autoritetit procedues, bën deklarime të cilat e inkriminojnë, autoriteti procedues është i detyruar të ndërpresë pyetjen, ta paralajmërojë personin se pas këtyre deklarimeve mund të zhvillohen hetime ndaj tij dhe ta ftojë të caktojë një mbrojtës. Deklarimet e mëparshme nuk mund të shfrytëzohen kundër personit që i ka bërë.

Neni 34 i KPP - Marrja e cilësisë së të pandehurit

Personi të cilit i atribuohet vepra penale, merr cilësinë e të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës. Ky akt i njoftohet edhe mbrojtësit të të pandehurit.

Neni 35 i KPP - Ndihma që i jepet të pandehurit të mitur

Kur i pandehuri është i mitur atij i sigurohet, përveç ndihmës juridike, edhe ndihmë psikologjike me praninë e prindit apo personave të tjerë të kërkuar nga i mituri.

Ndihma psikologjike është shumë e domosdoshme në të tilla raste, por duke qënë se praktika jonë ka treguar se ajo shpeshherë neglizhohet, avokati duhet dhe është pjesë e detyrës së tij që të këmbëngulë për ta siguruar. Prania e një personi i cili e ndihmon të pandehurin e mitur që të jetë në gjendje të mirë psikologjike, sidomos kur ky person është specialist i fushës sjell dobi të gjithanëshme për interesat e të miturit dhe për ndërtimin e marrëdhënieve midis aktorve pjesëmarrës në një procedim penal.

Duke qënë se specialistët psikologë ende nuk janë bërë pjesë normale e procedimeve penale ndaj të miturve rekomandohet ndërhyrja energjike e avokatit për të bërë të mundur që të miturit t'i sigurohet kjo ndihmë.

Neni 49 i KPP - Mbrojtësi i caktuar

Kur i pandehuri është nën moshën 18 vjeç ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme.

Nga këto dy dispozita të Kodit të Procedurës Penale del se për të miturit caktimi i avokatit është i detyrueshëm, në ndryshim nga të rriturit, të cilëve u sigurohet avokat vetëm kur e kërkojnë. Organi që proçedon penalisht duhet t'i caktojë avokat të pandehurit të mitur edhe kur ai nuk e kërkon atë.

Si gjatë hetimeve paraprake ashtu edhe në gjykim të miturit duhet t'i sigurohet ndihma psikologjike gjatë marrjes së tij në pyetje. Kjo gjë bëhet mirë kur në marrjen e të miturit në pyetje asiston një psikolog ose punonjës social, i cili ka aftësitë e nevojshme për komunikimin me të miturin dhe krijon kushtet e përshtatshme që i mituri të shprehët lirshëm dhe të shpjegojë saktësisht faktin për të cilin akuzohet.

Neni 309 i KPP - Caktimi dhe ndihma e mbrojtësit

Mbrojtësi i të pandehurit duhet të lajmërohet të paktën 24 orë përpara se të proçedohet me marrjen në pyetje të të pandehurit, me kqyrje apo ballafaqime.

Proçesverbalet dhe veprimeve të kryera, në të cilat mbrojtësi ka të drejtë të asistojë, depozitohen në sekretarinë e prokurorisë dhe mbrojtësi ka të drejtë të marrë kopje.

Një nga veprimet e para që duhet të bëjë avokati pasi autorizohet për të realizuar mbrojtjen është vendosja e kontakteve të qëndrueshme me organin proçedues. Në këtë rast është bërë praktikë vënia në

dispozicion të organit proçedues të numrit të telefonit të avokatit dhe adresa e saktë të zyrës.

Neni 42 i KPP - Verifikime për personalitetin e të pandehurit të mitur

“Organi proçedues merr të dhëna për kushtet e jetesës personale, familjare dhe shoqërore të të pandehurit të mitur me qëllim që të sqarojë përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë, të vlerësojë rëndësinë shoqërore të faktit dhe të caktojë masa të përshtatshme penale.

Organi proçedues mbledh informacione nga personat që kanë patur marrëdhënie me të miturin dhe dëgjon mendimin e ekspertëve”.

Kjo dispozitë shumë rrallë zbatohet në praktikë, prandaj është detyrë e mbrojtësit e të pandehurit të mitur që të ushtrojë ndikimin e nevojshëm tek organi proçedues për ta zbatuar ligjin në këtë çështje. Avokati në këtë rast rekomandohet t’i bëjë vetë këto verifikime në mënyrë që të realizojë një mbrojtje sa më profesionale të të miturit.

Neni 103 - Ndalimi i publikimit të aktit

“Ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale”.

Avokati duhet të bëjë kujdes në zbatimin e kësaj dispozite ligjore dhe të përdori të gjithë autoritetin e tij dhe mundësitë ligjore që kjo dispozitë të mos shkelet, pasi praktika ka treguar në mënyrë të përsëritur që mediat e shkruara shpesh publikojnë gjeneralitetet e të miturve të përfshirë në vepra penale.

Neni 110 i KPP - Memoriet dhe kërkesat e palëve

“Mbrojtësi ka të drejtë që në çdo gjendje dhe shkallë të proçedimit të paraqesë memorie dhe kërkesa me shkrim dhe organi proçedues duhet të shprehet me vendim brenda 15 ditëve”.

Është e rëndësishme që kjo dispozitë të mbahet parasysh pasi ka rezultuar shumë efikase në praktikë, sepse ndikon dukshëm në punën e organit procedues duke i dhënë mundësi avokatit të realizojë qëllimet e tij në funksion të mbrojtjes së klientit, të shpejtojë veprimet hetimore, të ndikojë cilësinë e tyre dhe të lërë gjurmë të domosdoshme për t'i përdorur gjatë hetimit gjyqësor.

Neni 151 i KPP - Marrja e provave

“Gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të përcaktuara në këtë kod”.

Provat e marra në shkelje të përcaktimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria ngrihet në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.

Neni 323 i KPP - Afati i hetimeve paraprake

Brenda tre muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj.

Neni 324 i KPP - Zgjatja e afatit

Ky nen përcakton kohëzgjatjen maksimale të hetimeve dhe procedurën se si zgjatet ajo.

Neni 325 i KPP - Ankimi për zgjatjen e afatit të hetimeve

Kundër vendimit të prokurorit për të zgjatur afatin e hetimeve mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 10 ditëve.

Avokati duhet të jetë i kujdesshëm për të mos lejuar zgjatje jo ligjore të afatit të hetimeve pasi sidomos në rastet kur të pandehurit e mitur

ndodhen në gjendje arresti, çdo ditë që kalon në këtë gjendje mund t'i shkaktojë dëm të pariparueshëm të miturit. Për këtë arsye avokati duhet të përdori me këmbëngulje ankimimin kundër vendimeve të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve.

Qëllimi i theksimit të këtyre tre dispozitave të fundit është për të tërhequr vëmendjen e avokatëve që duke i pasur parasysh, të bëjnë të mundur shmangjen e vonesave jo ligjore kur shqyrtohen çështjet e të miturve, vonesa të cilat ndikojnë më rëndë ndaj të miturit se sa ndaj të rriturve.

Neni 327 i KPP - Përfundimi i hetimeve

Në përfundim të hetimeve avokati ka të drejtë të njihet me të gjitha materialet e dosjes hetimore, përpara se prokurori të vendosë se çfarë do të bëjë me çështjen.

2.6 Gjykimi

Nenet 13 dhe 81 të KPP - seksionet për gjykimin e të miturve

“Gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse të krijuara në gjykatat e rrethëve gjyqësore të percaktuara me dekret të Presidentit të Republikës”.

“Kur disa nga procedimet që kanë lidhje midis tyre i përkasin kompetencës së gjykatës së zakonshme dhe të tjerat gjykatës që shqyrton çështjet me të mitur, kompetente për të gjitha procedimet është kjo e fundit”.

“Në rastet kur i pandehuri është madhor në kohën e gjykimin, por një ose disa vepra i ka kryer kur ka qënë i mitur, çështja gjykohet nga gjykata (seksioni) që shqyrton çështjet me të mitur”.

Krijimi i këtyre seksioneve do të jetë një hap përpara drejt ngritjes së gjykatave për të miturit, të cilat do të shqyrtojnë çdo çështje, penale e civile, ku të miturit janë palë ose të interesuar. Megjithatë mbetet të presim derisa të krijohet infrastruktura e nevojshme ligjore për funksionimin e seksioneve gjyqësore që do të jenë të specializuara dhe të veçantë për gjykimin e të miturve.

Neni 340 i KPP - gjykimi me dyer të mbyllura për të miturit

“Gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor të zhvillohet me dyer të mbyllura kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve”.

Ky përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i gjykimit me dyer të hapura bëhet për të evituar ekspozimin e të miturve dhe për të krijuar ambjent të përshtatshëm për gjykimin e tyre.

Neni 361 i KPP - pyetja e dëshmitarëve të mitur

“Pyetja e dëshmitarëve të mitur mund të bëhet nga kryetari, mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve. Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve. Kur mendohet se marrja në pyetje drejtpërdrejt e të miturit nuk e dëmton gjendjen psikologjike të tij, kryetari urdhëron që pyetja të vazhdojë sipas rregullave të përgjithshme. Urdhri mund të revokohet gjatë marrjes në pyetje”.

Zbatimi i këtyre rregullave ndihmon që marrja në pyetje e të miturve të bëhet e përshtatshme për moshën dhe i jep mundësi të miturit që të kalojë emocionet dhe të përgjigjet në mënyrën e duhur në një gjykim të rregullt.

Neni 403 - 406 i KPP - Gjykimi i shkurtuar

Një nga mënyrat ligjore për të lehtësuar sa më shumë që është e mundur gjendjen e të pandehurit të mitur është zhvillimi i gjykimit të

shkurtuar. Kjo dispozitë ka karakter të përgjithshëm, zbatohet si për të rriturit ashtu edhe për të miturit, por duhet mbajtur parasysh nga avokati pasi është një mjet efektiv për të çuar në minimumin e mundshëm dënimin me burgim për të pandehurin e mitur.

I pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm mund të kërkojë që çështja të përfundohet derisa të mos jetë filluar shqyrtimi gjyqësor.

Kërkesa bëhet me shkrim, kurse në seancë formulohet me gojë. Kërkesa me shkrim depozitohet në sekretarinë e gjykatës të paktën tre ditë para datës së caktuar për seancën.

Kur jep vendim dënimi, gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën e e tij.

2.7 Përjashtimi nga dënimi dhe masat edukuese

Neni 27 i Kushtetutës - mbikëqyrja e të miturit për qëllime edukimi

Liria mund të kufizohet “për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në një organ kompetent”.

Kjo dispozitë kushtetuese është konkretizuar në nenin 46 të Kodit Penal që rregullon mënyrat e caktimit dhe zbatimit të masave edukuese, për të cilat do të flitet më poshtë.

Neni 52 i KP - përjashtimi i të miturit nga dënimi

“Gjykata, nisur nga rrezikshmëria e pakët e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, nga sjellja e mëparshme e të miturit, mund ta përjashtojë atë nga dënimi”.

“Në këtë rast gjykata mund të vendosë dërgimin e të miturit në një institucion edukimi”.

Për zbatimin e kësaj dispozite kërkohet që të ekzistojnë njëherësh të gjithë kushtet e parashikuara në paragrafin e parë dhe jo vetëm njëri prej tyre. I mituri nuk mund të përjashtohet nga dënimi në qoftë se ka kryer një krim të rëndë apo në rethana të cilësuar ose kur sjellja e mëparshme e të miturit tregon që kemi të bëjmë me një të mitur i cili i ka të përsëritura sjelljet problematike dhe këshillimi i mëparshëm nuk ka sjellë rezultat.

Neni 46 i KP - masat edukuese për të miturit

“Masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale”.

Masa edukuese është vendosja e të miturit në një institucion edukimi.

Vendimi gjyqësor për masat edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë, por në çdo rast kryesisht gjykata është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj”.

Nga kjo dispozitë del se vendosja e të miturit në institucion edukimi mund të bëhet vetëm me vendim të gjykatës në dy raste:

- o kur në përfundim të gjykimit të tij gjykata vendos ta përjashtojë nga dënimi, në bazë të nenit 52 të Kodit Penal, dhe
- o kur i mituri, për shkak të moshës, nuk mund të gjykohej penalisht për një akt që përbën vepër penale.

Në këtë rast, me kërkesë të prokurorit, gjykata vendos masën edukuese të vendosjes së të miturit në një institucion edukimi. Këtë kërkesë prokurori e bën duke u bazuar në të dhënat e policisë ose edhe kryesisht. Prandaj kërkohet një bashkëpunim i vazhdueshëm midis tyre.

2.8 Alternativat e dënimit me burgim

Me qëllim që të shmanget sa më shumë të jetë e mundur dënimi me burgim për të miturit, më poshtë janë nxjerrë në pah alternativat e dënimit me burgim të cilat duhet të orientojnë mbrojtjen e avokatit të të miturit kur ai vleron se klienti i tij i mitur rrezikon të dënohet me burgim.

Neni 58 i KP - Copëzimi i dënimit me burgim

Kur gjykata vëren rrethana të rënda familjare, mjekësore, profesionale apo shoqërore, vendos që dënimi të ekzekutohet me copëzime jo më të vogla se dy ditë në javë për dënimet me burgim deri në një vit.

Në çdo rast ekzekutimi i vendimit duhet të përfundojë brenda tre vjetëve.

Kur këto rrethana nuk ekzistojnë më, ose kur i dënuari shkel detyrimet e caktuara në vendim, gjykata bënë revokimin e vendimit të dhënë me copëzim.

Copëzimi i dënimit me burgim mund të përdorej në shumë raste për të miturit pasi në këtë mënyrë bën të mundur mbajtjen e raporteve familjare tek i mituri për të cilat kjo moshë ka ende shumë nevojë.

Neni 59 i KP - Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim

Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale, gjykata kur jep dënim deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të vihet në provë duke u pezulluar ekzekutimi i dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale po aq të rëndë apo më të rëndë. Afati i provës është tetëmbëdhjetë muaj deri në pesë vjet.

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vendosja e të miturit në provë mund dhe duhet të aplikohet gjerësisht tek të miturit sidomos kur ata dënohen për herë të parë. Arsyeja e parë është sepse në këtë mënyrë përmbushen përcaktimet lidhur me dënimin me burgim të përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe të dala nga fryma e ligjit tonë të përmendur më sipër, e dyta sepse në përgjithësi duke konsultuar statistikat të miturit, për shkak të rrezikshmërisë së pakët

dhe gjysmës së masës së dënimit që aplikohet për ta, përmbushin kriteret për aplikimin në përgjithësi të kësaj dispozite dhe e treta për shkak të karakteristikave të adoleshencës, lidhur me zhvillimin e tyre psiko-emocional, shumë prej tyre përfshihen në veprime të kundraligjshme kriminale rastësisht.

Aplikimi i kësaj dispozite do të interpretohej në këtë rast si dhënia e një mundësie tjetër për ta sidomos kur familja tregon interes dhe merr dukshëm përgjegjësitë për tu kujdesur. Një gjë e tillë mund të pasurohet edhe me vazhdueshmërinë e programit arsimor përkatës.

Neni 60 i KP - Masat ndaj të dënuarit të vënë në provë

I dënuari i vënë në provë mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër nga masat të mëposhtme:

- Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional.
- Të mos frekuentoj vende të caktuara.
- Të mos frekuentoj lokale që shërbejnë pije alkoolike.
- Të qëndroj në banesën e tij në orare të caktuara.
- Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuarit apo bashkëpunëtorët e veprës penale.
- Tu nënshtrohet masave mjekësore kundër alkoolit dhe narkotikëve.

Këto masa janë parashikuar me shumë vend në kodin tonë penal, pavarësisht se rrallë aplikohen. Është detyrë e avokatit së të miturit që të tërheqë vëmendjen e gjykatës për aplikimin e tyre në mënyrë që t'i shërbehet sa më mirë interesit të minorenit.

Neni 63 i KP - Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune me interes publik

Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale kur është caktuar dënimi deri në një vit

burgim, gjykata mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë me interes publik.

Puna me interes publik jepet për një kohë nga dyzet gjer në dyqind e dyzet ore dhe konsiston në kryerjen nga i dënuari të një pune pa shpërblim në favor të interesit publik apo shoqatës të caktuar në vendimin e gjykatës.

Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në seancën gjyqësore.

Puna me interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh.

Në vendimin e saj gjykata cakton orët e punës si dhe ditët e javës kur do të kryhet ky shërbim.

Pas përfundimit të punës, detyrimi konsiderohet i paqënë.

Ky lloj pezullimi ndjek të gjitha rregullat që janë vendosur në nenet 61 e 62 të këtij Kodi.

Siç shihet edhe nga dispozita e mësipërme legjislatori në marrjen e këtij vendimi nga ana e gjykatës përmend tre elemente të cilat mund të shërbejnë si premisa për marrjen e tij, të cilat janë rrezikshmëria e pakët e personit, rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe kur dënimi i caktuar është deri në 1 vit burgim.

Në qoftë se do t'i referohemi praktikës gjyqësore vërejmë se të miturit zënë një pjesë të konsiderueshme të subjekteve penale të cilët, për shkak të veçorive psiko-fizike të tyre, dënimit me gjysmën e kohës së dënimit, trajtohen me masa dënimi gjer në 1 vit. Nga ana tjetër të miturit në vetvete mbartin rrezikshmëri shoqërore më të ulët se të rriturit dhe mundësia e tyre për rehabilitim është më e madhe.

Bazuar në sa më sipër ekzistojnë të gjitha premiset për të praktikuar gjerësisht këtë lloj alternative dënimi, aplikimi i të cilës në rradhë të parë e edukon të miturin me punën dhe e bën atë dobishëm për shoqërinë, ndihmon në parandalimin e reçidivizmit nëpërmjet krijimit të aftësive profesionale dhe prodhuese tek ai duke arritur në këtë mënyrë më shpejt riedukimin dhe riintegrimin e tij në shoqëri, gjë e cila përbën edhe parimin bazë të qëllimit të dënimit.

Ky aspekt gjen përshtatje në nenin 31 të ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në të cilin thuhet se: “Kur gjykata në vendimin e dënimit me burgim ka vendosur pezullimin dhe zëvendësimin e tij me kryerjen e një pune me interes publik, prokurori me urdhërin e ekzekutimit ja kalon çështjen për veprim organit përmbarimor sipas rregullave të parashikuara në nenin 63 të Kodit Penal. Organet lokale të pushtetit, mbi kërkesën e organit të përmbarimit brenda juridiksionit administrativ të tyre, janë të detyruara të njoftojnë për personat juridikë publik a privat që kryejnë punë në interes publik”.

2.9 Dënimi me burgim për të Miturit

Neni 40 i “Konventa mbi të drejtat e fëmijës”

Shtetet palë i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.

Kodi Penal nuk i ka bërë të miturit një trajtim të posaçëm apo të veçantë për sa i përket llojeve të dënimeve për të miturit. Përveç masës edukuese me detyrimin e të miturit për futjen në një institucion riedukimi, llojet e tjera të dënimit janë të njëjta me ato për të rriturit.

I vetmi ndryshim që parashikohet është në masën e dënimit për të miturit e cila nuk mund të jetë më shumë se 1/2 e dënimit që parashikohet për një të rritur për të njëjtën vepër penale.

Në këto kushte kur vendoset një masë sigurie me burgim për të miturin ose kur do jepet një dënim me burgim duhen marrë parasysh tre përcaktime të Konventës mbi të drejtat e fëmijës që janë: 1. burgimi duhet të jetë masa e fundit që duhet marrë në rastin konkret kur çdo masë tjetër është konsideruar si e papërshtatshme, 2. burgimi duhet të

jetë për një kohë sa më të shkurtër të jetë e mundur dhe 3. në çdo rast duhet verifikuar dhe arsyetuar “interesi më i lartë i fëmijës”.

Neni 51 i KP - dënimi me burgim për të miturit

“Për të miturit që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer”.

Neni 31 i KP - dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet për të miturit

“Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe për gratë”.

Për sa i përket dënimit të të miturve është me vend të theksojmë se në bazë të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992, parimi kryesor mbi të cilin duhet të bazohen autoritet vendimarrëse për çdo lloj vendimi që ato marrin për të miturit është “Interesi më i lartë i fëmijës”. Vendimi gjyqësor i cili normalisht sanksionon në të shumtën e rasteve një dënim duhet në çdo rast ta ketë ekzaminuar dhe ta ketë marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës.

2.10 Ankimimi i Vendimit

Neni 410 i KPP - ankimi i të pandehurit të mitur kundër vendimit të gjykatës

Kujdestari i të pandehurit mund të bëjë çdo ankim që i takon të pandehurit.

“I pandehuri mund ta tërheqë ankimin e bërë nga mbrojtësi i tij, por

kur ai nuk ka zotësinë juridike për të vepruar duhet të merret edhe pëlqimi i kujdestarit”.

Ky rregull ka për qëllim të mbrojë interesat e të miturit, duke siguruar edhe ndihmën e prindit e të kujdestarit për rastin e ankimit kundër vendimit të gjykatës.

2.11 Ekzekutimi i vendimit dhe vuajtja e dënimit me burgim

Neni 464 i KPP - ekzekutimi i vendimeve me burgim

“Për ekzekutimin e një vendimi me burgim dhe të vendimeve të mbylljes së detyrueshme në institucione edukimi, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit”.

Në këtë urdhër prokurori tregon me hollësi rregullat ligjore të veçanta që duhet të zbatohen nga administrata e burgut ose ajo e institucionit të edukimit.

Neni 33/3 i KP - vuajtja e dënimit me burgim për të miturit

“Të miturit e kryejnë dënimin me burgim në vende të veçanta nga të rriturit”.

Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj dispozite janë parashikuar në Ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe Ligjin nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

